



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 24 regjistër (JR)
Datë 03.06.2022

Nr. 8 i vendimit
Datë 02.03.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, ditën e enjte, më datë 02.03.2023, në orën 15:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Ndryshimi i vendimit nr. 519, datë 25.3.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet dhe kërkimet e Komisionerit Publik të paraqitura në ankim dhe në konkluzionet përfundimtare, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit të Pavarur të

Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi, parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, paraqitur prej tij dhe avokatit të tij Julian Mërtiri, që kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016.

2. Mbështetur në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”). Konkretisht:

2.1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së kreu procedurën e kontrollit të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit¹ dhe, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar², duke konstatuar se:

- (i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
- (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
- (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja³ kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo elemente që cenojnë figurën e tij, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe ka konstatuar përshtatshmërinë në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit. Ky konkluzion u konfirmua edhe pas kërkesës së Komisionit, datë 23.09.2021, për përditësim të informacionit.

2.3. KLGj-ja ka kryer analizën e aftësive profesionale dhe e ka dërguar atë në Komision⁴.

¹ Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar deklaratën e pasurisë pranë ILDKPKI-së, brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

² Raporti i ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 22.01.2019.

³ Raporti i DSIK-së nr. {***}, datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. {***}, datë 5.10.2021, dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 07.10.2021.

⁴ Raporti i KLGj-së nr. {***} prot., datë 23.7.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 519, datë 25.3.2022, Komisioni vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi, pasi arsyetoi se ai kishte arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, të figurës, dhe nivel kualifikues në vlerësimin e kriterit profesional. Sipas çështjeve të shqyrtuara për secilin kriter, Komisioni vlerësoi me arsyetimin e përmbledhur si vijon.

3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm sipas gurmës “a”, pika 1, neni 59 i ligjit nr. 84/2016. Në vlerësimin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit:

- (i) ka kryer deklaratime të sakta në deklaratën *vetting* dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e rivlerësimit;
- (ii) pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore nuk rezultuan të kenë qenë të qëllimshme apo të kenë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklaratime të rreme;
- (iii) subjekti nuk rezulton të ketë qenë në ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit;
- (iv) nga hetimet e thelluara edhe për deklaratime të kryera pas deklaratës *vetting*, në lidhje me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaratimeve të kryera përpara kësaj deklarate nga ana e subjektit dhe e personave të lidhur, rezultoi se ka qenë në koherencë të plotë dhe në vijueshmëri të deklaratimeve nga viti 2014, kur subjekti ka rifilluar të ushtrojë detyrën e gjyqtarit dhe deri në deklaratën *vetting*.

3.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, sipas gurmës “b”, pika 1, neni 59 i ligjit nr. 84/2016, pasi nuk u evidentuan të dhëna që cenojnë figurën e tij, si: kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo veprimtari të tjera kriminale, si dhe të dhëna për korrupsion.

3.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht pasi ka arritur nivel kualifikues për vlerësim të aftësive profesionale, sipas parashikimeve të gurmës “c”, pika 1, neni 59 i ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

4. Më datë 24.05.2022, Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”), bazuar në rekomandimin e ONM-së, ushtroi të drejtën e ankimit kundër vendimit të Komisionit, duke vlerësuar se vendimi është i cenusshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur për shqyrtim juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Bashkëlidhur ankimit, gjendet kopja e rekomandimit të ONM-së për ankim, nënshkruar nga 3 vëzhgues ndërkombëtarë⁵, që mban datën 16.05.2022.

⁵ Rekomandimi i ONM-së, për paraqitje ankimi ndaj vendimit nr. 519, datë 25.3.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi, është administruar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë me nr. {***} prot., datë 16.5.2022.

5. Në ankimin e tij, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, duke sjellë në pah sa vijon.

5.1. Lidhur me pasurinë “shtëpi banimi me sip. 180 m², {***}, {***}, New York {***}, ShBA” (në vijim “shtëpi banimi në ShBA”), subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për sa vijon.

5.1.1. Mospërputhjet në deklaratimet e subjektit mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie, vlerën e kredisë nga *W. F. Bank* (në vijim “WF Bank”), dhe si rrjedhojë pagesën e këstit të dytë, çojnë në deklaratim të pasaktë. Rrethanat e pasqyruara në deklaratën e pasurisë përpara fillimit të detyrës dhe në deklaratën *vetting*, si dhe përgjigjet e subjektit gjatë hetimit administrativ në Komision deri në përgjigjet në pyetësorit nr. 3, janë të pasakta dhe të paplota mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie: të pasakta për shumën e kredisë, disbursuar nga WF Bank, të pasakta dhe të pamjaftueshme për pagesën e këstit të dytë, në shumën 46.638 USD.

5.1.2. Në lidhje me burimin e krijimit të pagesave të këstit të parë dhe të dytë për krijimin e kësaj pasurie, në vlerat 29.000 USD dhe 46.638 USD, në konsideratë të kryerjes së analizës financiare duke nisur që nga viti 2003 (muaji shtator), rezultatet e analizës financiare do të ndryshonin mundësinë për kursim të subjektit dhe të familjarëve të tij, duke rezultuar në pamjaftueshmëri financiare për periudhën shtator 2003 – 21.5.2012, për një shumë të akumuluar në vlerën rreth (-) 16.000 USD.

5.2. Lidhur me *depozitat në Chase Bank dhe TD Bank në New York, ShBA*, për sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit të kursimeve deri në datën 10.07.2014, analiza financiare duhet të kryhet për periudhën duke filluar që nga muaji shtator 2003. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe pamjaftueshmëria financiare e akumuluar deri në datën 10.7.2014, e llogaritur si rezultat i shumatores së mundësisë së kursimeve të subjektit të rivlerësimit për vitet 2003 – 10.7.2014, do të rezultonte në vlerën rreth (-) 25.863 USD.

5.2.1. Pamjaftueshmëria e konstatuar ndër vite, sikundër trajtuar në dy çështjet e mësipërme, do të ndikonte edhe rezultatin financiar të akumuluar të vitit 2015, vit në të cilin është shlyer pjesërisht kredia për shkollimin e bashkëshortes së subjektit, duke e kthyer atë në negativ.

5.3. Në përfundim, Komisioneri Publik ka kërkuar që shkaqet e parashtruara në ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit dhe, pas vlerësimit tërësor të procedurave, në përfundim të gjyqimit të çështjes, të vendosë ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 519, datë 25.3.2022, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi. Në konkluzionet e tij përfundimtare, Komisioneri Publik parashtrroi se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegji, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe se ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

6. Bazuar në pikat 3 dhe 7 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës, në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik i kërkoi Kolegjit ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 519, datë 25.3.2022, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi.

IV. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit

7. Në rekomandimin e tyre, i cili është përthithur në ankimin e Komisionerit Publik, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c” e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 65, pika 22 e ligjit nr. 84/2016, tre vëzhgues ndërkombëtarë të ONM-së trajtojnë çështje që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, duke sjellë në pah sa vijon.

7.1. Lidhur me pasurinë shtëpi banimi në ShBA, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi saktësisht shumën e kredisë dhe *këstin e dytë* të pagesës në deklaratën *vetting*, në pyetësonin standard dhe pyetësonin nr. 2. Subjekti i deklaroi ato vetëm në përgjigje të pyetësonit nr. 3, në muajin tetor 2021. Deklarimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në lidhje me shumën e huas, përbëjnë mungesë të deklaramit të saktë apo më së paku, një situatë të pasaktësisë në deklaram deri në muajin tetor 2021, të cilat në përfundim çojnë në thyerje të besimit të publikut.

7.1.1. Nën dritën e sa më sipër, ONM-ja vlerëson të pasakta konkluzionet e Komisionit se: (i) *subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktësisht vlerën e kredisë në shumën 217.500 USD në rubrikën e detyrimeve në deklaratën e pasurisë përpara fillimit të detyrës*, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit në këtë rubrikë deklaroi se kredia e marrë ishte në shumën 261.000 USD dhe detyrimi i mbetur në vitin 2014, ishte 217.500 USD; (ii) *mosdeklarimi i shumës prej 46.638 USD, paguar nga vëllai i subjektit në datën 21.5.2012, nuk është bërë me qëllim fshehjen e kësaj pagese, por për të qenë në të njëjtën linjë me kontratën e shitjes më datë 17.2.2012*, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar pagesën e këstit të dytë në asnjë prej deklaratave të pasurisë.

7.1.2. Për një vlerësim korrekt të kriterit të pasurisë, në interpretim korrekt të situatës ligjore dhe faktike, analiza financiare duhet të përfshijë *të gjithë* periudhën që subjekti dhe familja e tij kanë banuar në ShBA, duke filluar nga viti 2003, pasi *së pari*, për dy pasuri të deklaruara në deklaratën *vetting*, shtëpi banimi në ShBA dhe llogari bankare e çelur në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burim krijimi të ardhurat përpara fillimit të detyrës në vitin 2014; *së dyti*, në momentin e deklaramit të pasurisë përpara fillimit të detyrës, si pjesë e deklaramit, subjekti nuk ishte në pamundësi objektive për të siguruar dokumentacion për të ardhurat për vitet 2003 dhe 2004, fakti që nuk ka paraqitur dokumente të pagimit të taksave për gjithë periudhën 2003-2004, është tregues i faktit që nuk ka pasur të ardhura të ligjshme, dhe jo i të qenit në kushte të pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacionin lidhur me to; është në diskutim nëse subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për periudhën gusht 2003 - korrik 2004, për sa kohë që nuk kishte leje pune nga autoritetet e ShBA-së, sikundër edhe i ati dhe i vëllai nuk mund të krijonin të ardhura të ligjshme për të njëjtën periudhë, për të njëjtat arsye.

7.1.3. Sipas OMN-së, në konsideratë të analizës financiare nga viti 2003, do të rezultonin balancat negative: (i) për vitin 2012, në vlerën (-) 16.088 USD, për rrjedhojë subjekti nuk do të kishte të ardhura të ligjshme për të paguar këstin e dytë të kredisë për shtëpinë; (ii) për vitin 2014, në vlerën (-) 24.593 USD, për rrjedhojë subjekti nuk do të kishte të ardhura të ligjshme për llogarinë bankare, për të paguar këstet e kredisë bankare, për të paguar shumën 8.438 USD për huan e bashkëshortes; (iii) për vitin 2015, në vlerën (-) 21.140 USD, për rrjedhojë subjekti nuk do të kishte të ardhura të ligjshme për të paguar këstet e kredisë bankare, për të paguar shumën 8.538 USD për huan e bashkëshortes.

7.1.4. Nën dritën e sa më sipër, ONM-ja i vlerëson të pasakta konkluzionet e Komisionit se: (i) subjekti nuk ka krijuar pasuri në vitet 2003 dhe 2004 dhe as likuiditete të mbartura në deklaratën *vetting* dhe, në këto kushte, Komisioni nuk mund të ketë objekt hetimi periudhën gusht 2003 - dhjetor 2004; (ii) llogaria bankare e çelur në gusht të vitit 2004, është bërë për arsye praktike dhe jo për të krijuar pasuri/likuiditete; (iii) subjekti nuk ka pretenduar që të ardhurat e periudhës gusht 2003 - dhjetor 2004, të kenë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie të tij; (iv) në DPFDF-në e vitit 2014 dhe në vijim, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI dokumente shkresore që vërtetojnë të ardhura nga viti 2005 dhe në vijim, çka tregon se sipas deklarimeve të tij, këto të ardhura kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive të tij dhe jo të ardhura të viteve 2003 dhe 2004; (v) Komisioni nuk mund të anashkalojë faktin që si periudha gusht 2003 - dhjetor 2004, ashtu si edhe periudha 2005 - 2012, kur është blerë pasuria, i përkasin periudhës jashtë ushtrimit të detyrës dhe kur subjekti ka qenë në ShBA, dhe referuar qëndrimin të mbajtur nga Komisioni në disa vendime të formës së prerë, pozita e subjekteve të rivlerësimit nuk mund të rëndohet me qëllim provueshmërinë e ligjshmërisë së pasurive me të ardhura të cilat nuk janë krijuar dhe as nuk lidhen me periudhën e rivlerësimit kalimtar e, në këtë mënyrë, subjektet e rivlerësimit nuk mund të penalizohen për këtë arsye.

7.2. Në konkluzion të sa më sipër, ONM-ja vlerëson se vendimi i Komisionit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi ka mangësi serioze logjike dhe faktike në pjesën arsyetuese dhe është rezultat i një procesi rivlerësimi të papërshtatshëm dhe të pasaktë për kriterin e pasurisë, dhe aplikimit të gabuar të kuadrit ligjor në fuqi. ONM-ja çmon se një vlerësim i duhur i kriterit të pasurisë në tërësinë e tij, do të çonte në shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që ai nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e këtij kriteri, sipas nenit 59, pika 1, germa “a”, lidhur me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe beson se një vlerësim i përgjithshëm i mangësive të evidentuara do të ndikojë në besimin e publikut.

V. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj

- 8.** Në parashtrimet e paraqitura përpara çeljes së seancës gjyqësore publike, si dhe në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesi i tij ligjor, avokat Julian Mërtiri, pretenduan se shkaqet e ankimit të Komisionerit nuk qëndrojnë në raport me provat, faktet,

dokumentet dhe shpjegimet e dhëna, sikurse edhe me dispozitat e ligjit nr. 84/2016, Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Shkaqet e ankimit, po ashtu, bien ndesh me dispozitat e ligjit nr. 10428, datë 02.06.2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private.” Sipas subjektit, provat dhe dokumentet e marra kryesisht nga ana e Komisionit apo dhe ato të paraqitura prej tij, si dhe faktet dhe shpjegimet e paraqitura gjatë dhe në përfundim të hetimit administrativ, provojnë bazueshmërinë dhe drejtësinë e vendimmarrjes së Komisionit në të tria kriteret. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë përmbledhur në vijim.

8.1. Për sa i përket pasurisë “shtëpi banimi me sip. 180 m²” në New York⁶, blerja është kryer përpara fillimit të detyrës. Gjatë kësaj kohe, nuk ishte subjekt deklarues nën përgjegjësinë e deklarimit të pasurisë sipas ligjit nr. 9049/2003 dhe të gjitha transaksionet janë kryer përmes rrugëve bankare. Sipas subjektit, hetimi administrativ i Komisionit për këtë çështje, bazohet në sa paraqitur e deklaruar prej tij dhe, si rrjedhojë, referuar jurisprudencës së konsoliduar “të organeve të *vetting*-ut”, kjo pasuri nuk i duhet nënshtruar hetimit të thelluar. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka kryer deklarime kontradiktore për shkaqet e ankimit sa vijon.

8.1.1. Për deklarimin e shumës së kredisë së financuar nga *W. F. Bank*, shuma e saktë e kredisë së fituar, prej 217.500 USD, është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në deklaratën e pasurisë përpara fillimit të detyrës në vitin 2014 (në vijim DPDFD 2014), dhe në pyetësin nr. 2, përgjigjen e pyetjes 5/b; në përgjigje të pyetësorit standard ka deklaruar sa është kërkuar.

8.1.1.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, i është referuar kontratës së shitjes së pasurisë, dokumentit “*Residential Contract of Sale*”, ku specifikohet çmimi i blerjes së banesës në ShBA, në vlerën 290.000 USD, i pagueshëm: (a) parapagim (*downpayment*) 29.000 USD; (d) teprica në përfundim/me dakordësimin e palëve, në përputhje me paragrafin 7: 261.000 USD. Nuk i është referuar kontratës së kredisë/dokumentit “*Conventional Commitment Letter [Notice of Terms]*”, ku specifikohet ekzaktësisht shuma e financuar nga banka, 217.500 USD, pas verifikimit të pozitës/situatës financiare të dy bashkëblerësve (subjektit dhe vëllait të tij). Nga analiza e riskut, në qasje më konservatore për shkak të situatës, banka mund të financonte për blerjen e pasurisë deri në shumën 217.500 USD dhe jo 261.000 USD, si specifikuar në kontratën e shitjes. Në përmbushje të kërkesave të bankës, si për të kryer blerjen e pasurisë në të njëjtën datë me lëvrimin e kredisë, më 21.05.2012, diferenca prej 46.638,43 USD u pagua me çek bankar nga vëllai [K. G.] për “{***}” (institucioni financiar kreditues i shitësit).

8.1.1.2. Në DPDFD-në 2014, në rubrikën dedikuar detyrimeve financiare, ka përzier të dhënat e kontratës së shitjes me atë të kontratës së kredisë, në seksionin ku kërkohet “Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa u shlyer deri datën e fillimit të punës”, pasi vlera 217.500 USD përkon me shumën e kredisë së financuar; nga sa përshkruar, evidentohet diferenca e paguar në shumën 43.500 USD, së cilës, nëse i shtohen komisione disbursimi/administrimi për kredinë, përftohet pagesa e kryer prej vëllait, në vlerën 46.638,43 USD, në datën e disbursimit të kredisë. Sipas

⁶ Me adresë të plotë: {***}, {***}, New York {***}, ShBA.

subjektit, deklarimi në DPDF-në 2014, konsiston në pjesën e detyrimeve të likuiduara prej tij personalisht për finalizimin e kontratës, vlerën e banesës prej 290.000 USD dhe të detyrimit të likuiduar prej tij personalisht me çek bankar më datë 16.02.2012, prej 29.000 USD. Ka deklaruar saktë shumën e kredisë bankare prej 217.500 USD në rubrikën e detyrimeve financiare, duke pasqyruar në mënyrë fotografike momentin e krijimit të pasurisë (21.05.2012), dhe jo momentin e deklarimit (10.07.2014). Në kushtet e deklarimit *për herë të parë dhe mosinterpretimit të saktë të dhënave të dokumentacionit në terma financiarë*, formalisht nuk ka pasqyruar drejt të dhënat duke menduar se dokumentacioni provues ka qenë i mjaftueshëm për përmbushjen e detyrimit për deklarim, në përputhje me ligjin nr. 9049/2003 dhe me kërkesat e formularëve përkatës në respektim të tij.

8.1.1.3. Në përgjigje të pyetjes 9 të pyetësorit standard, ka paraqitur informacion për t'iu përgjigjur pyetjes për shpenzime mbi 2500 euro, si dhe ka referuar saktësisht sa ka paguar me çek bankar më datë 16.02.2012, nga llogaria e tij bankare. Pjesa tjetër e përgjigjes i referohet diferencës së mbetur të çmimit sipas kontratës së shitjes. Diferenca prej 46.638,43 USD është paguar nga i vëllai e, për rrjedhojë, nuk mund të përfshihej prej tij në përgjigjen e pyetjes.

8.1.2. *Kësti i dytë për blerjen e pasurisë, në vlerën prej 46.638,43 USD*, është dokumentuar në përgjigje të pyetësorit nr. 5. Përkundër sa pretendon Komisioneri, kjo pagesë nuk është deklaruar për herë të parë në këtë pyetësor. Sipas subjektit, ajo: (i) evidentohet lehtë nga leximi i kujdesshëm i dokumentacionit të depozituar në ILDKPKI, si diferencë mes çmimit të blerjes së banesës, për 290.000 USD, me shumën e detyrimit të pashlyer, 217.500 USD, deklaruar në vitin 2014 në DPDF, ndërkohë që pjesën e tij takuese e ka deklaruar në mënyrë të shprehur; (ii) është deklaruar *indirekt* si diferencë e paguar, në *deduksion* të një veprimi të thjeshtë aritmetikor, për sa në deklarimin përpara fillimit të detyrës dhe deklarimet në vijim, ka deklaruar saktë çmimin e blerjes së pasurisë dhe detyrimin e pashlyer për kredinë bankare; (iii) në përgjigjet për pyetësorin standard dhe të pyetësorit nr. 2, u ka qëndruar rigoroz pyetjeve duke deklaruar saktë për sa është kërkuar.

8.1.2.1. Duke sjellë në vëmendje se pagesa prej 46.638,43 USD ka kaluar testin e auditimit financiar Federal të kryer pranë Internal Revenue Service (IRS në ShBA) dhe të shtetit të New York-ut (State Department of Taxation and Finance), atë të auditimit privat nga banka financuese, testin e pastrimit të parave (*Anti-Money Laundering 9, Vigjilencë e Zgjeruar*), subjekti i rivlerësimit pretendon se mungon qëllimi për të mos e treguar këtë pagesë, dhe nuk gjen vend shkaku i ankimit për mungesë të mosdeklarimit të kësaj pagese, të kryer nga i vëllai. Pasuria është krijuar tërësisht me të ardhura të përfituara në ShBA dhe ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme. Për rrjedhojë, nuk ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm.

8.2. *Lidhur me paraqitjen e dokumentacionit për periudhën 2003-2004*, subjekti i rivlerësimit pretendon se shkaqet e ankimit të Komisionerit janë alogjike, në shtrembërim të fakteve dhe të pabazuara në dokumente e ligj. Subjekti pretendon se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive, e parashikuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për paraqitjen e dokumentacionit në kohën e dorëzimit të deklaratës *vetting*, pasi ishte tejkualuar afati maksimal 10-vjeçar për ruajtjen e tij. Nuk

ka konstatuar asnjë përpjekje të Komisionit apo të vëzhguesit ndërkombëtar për të marrë informacionin e kërkuar përtej sa paraqitur prej tij, apo për të kryqëzuar informacionin e dhënë nëpërmjet kërkesave drejtuar institucioneve përkatëse, siç veprohet me institucionet brenda territorit të Shqipërisë⁷.

8.2.1. Sipas subjektit, Komisioneri Publik ngatërron detyrimin e tij për paraqitje të dokumentacionit provues të pasurive dhe burimeve të krijimit të tyre, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, me dorëzimin e dokumentacionit pranë ILDKPKI-së, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë përpara fillimit të detyrës. Bashkëlidhur DPDFD-së 2014, ka pasur detyrimin ligjor për të depozituar dokumentacion për të justifikuar burimet e krijimit të pasurive në pronësi, posedim apo/dhe përdorim. Ndërsa në deklaratën e pasurisë [*vetting*] i është kërkuar të depozitohet dokumentacion provues për të gjitha të ardhurat e krijuara ndër vite, përfshirë edhe vitin 2003 dhe 2004. Me logjikën e përdorur në ankim, nëse do të ishte kërkuar përmbushja e të njëjtit detyrim, do të kishte paraqitur në ILDKPKI dokumentacion justifikues për të ardhurat e tij prej vitit 1999 e në vijim.

8.2.2. Për pasuritë e ndodhura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, parashikimet e pikës 3 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, marrin në konsideratë afatet kohore të ruajtjes së dokumentacionit sipas përcaktimeve ligjore në vendet respektive. Pamundësia objektive për të dorëzuar dokumentacion për të ardhurat nga punësimi, për këtë periudhë, ka lindur që me dorëzimin e deklaratës së pasurisë *vetting*, kur ishte tejkaluar afati ligjor maksimal 10-vjeçar për ruajtjen e dokumentacionit⁸.

8.2.3. Në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, subjekti pretendon se ka përmbushur detyrimin për deklarimin e pasurive në pronësi, përdorim dhe/apo posedim deri në datën e deklarimit në DPDFD 2014, bashkëlidhur së cilës ka depozituar dokumentacionin provues. Pas marrjes së detyrës si gjyqtar, në muajin korrik 2014, për shkak të parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003, megjithëse dispononte *tax returns* prej vitit 2005, ka kërkuar informacion për gjithë periudhën e punësimit në ShBA, dhe ka marrë kopje të formularëve të deklarimit të taksave të viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2013, që vërtetojnë të ardhurat e asaj periudhe. Për deklaratimet e taksave para vitit 2010, afati i kthimit të përgjigjes do të ishte disa muaj. Ndodhur në kufij të afateve të dorëzimit të deklaratës para fillimit të detyrës [*dorëzuar më 08.08.2014, ndërsa tax transcripts janë printuar nga IRS më datë 05.08.2014*], si dhe duke disponuar *tax returns* prej vitit 2005 e në vijim, nuk ka vijuar kërkimet. Periudha para vitit 2005 “ka qenë periudhë stabilizimi”, shprehet subjekti. Ka prezumuar

⁷ Subjekti për këtë pretendim referon vendimin e Kolegjtit nr. 6 (JR), datë 17.03.2022, paragrafët 12, 13, 15.2, 15.3, 15.5 dhe 15.6.

⁸ Subjekti referon informacionin nga faqja zyrtare e Shërbimit të Taksave të Brendshme në ShBA [Internal Revenue Service, agjencia federale e taksave, IRS], sipas së cilës afati i ruajtjes së dokumentacionit për transkriptin e deklarimit të taksave [**Tax Return Transcript**], është i ruajtur për vitin aktual dhe tre vite pararendës subjekt taksimi. Përllogaritja e transkriptimit të taksave [**Tax Account Transcript**], ruhet gjatë vitit aktual dhe nëntë vite subjekt taksimi të mëparshme.

se dokumentacioni i disponuar ishte i plotë për të justifikuar krijimin e pasurisë, provuar kjo edhe nga analiza financiare e Komisionit për periudhën 2005 - 21.05.2012.

8.2.4. Në mungesë të *tax return*-it apo informacionit tjetër provues, provat e paraqitura në Kolegj, kopja e licencës si agjent imobiliar (*Sales Person*), lëshuar nga Departamenti i Shtetit të New York-ut, me datë efektive më 31.12.2004, kopja e kartës hyrëse/identifikuese lëshuar nga Washington Inventory Service [WIS], printuar më datë 29.12.2004, dhe barkodi respektiv, tregojnë se ka qenë në marrëdhënie pune për këtë periudhë.

8.2.5. Duke i qëndruar pretendimit se ka bërë deklarin për taksat për periudhën 2003-2004, dhe se është në pamundësi objektive për të paraqitur *tax return*-in, me gjithë përpjekjet e bëra prej tij, në referim të legjislacionit fiskal amerikan në lidhje me kufirin e të ardhurave nga fillon detyrimi për deklarin⁹, subjekti i rivlerësimit kërkon që Kolegji të llogarisë së paku të ardhura vjetore në kufirin e të ardhurave nga fillon detyrimi për deklarin, ose në skenarin më pesimit, të ardhurat e përjashtuara nga taksimi çka, sipas tij, do të mbulonte pamundësinë financiare të konstatuar për këtë periudhë.

8.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshton pretendimin e Komisionerit Publik dhe qëndrimin e ONM-së, për shtrirjen e analizës financiare edhe për vitet 2003-2004, duke pretenduar se vlerësimi i ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive të tij në ShBA, duhet të fillojë nga viti 2005 deri në datën e krijimit të tyre, pretendim për të cilin parashtron si vijon.

8.3.1. Llogaria bankare, deklaruar në deklaratën *vetting* dhe deklaratat e pasurisë dorëzuar pranë ILDKPKI-së, është çelur pas pajisjes me numër pune, hap i nevojshëm për të përmbushur detyrimet (pagesa utilitare, kalim page, pagesa të tjera). Pasuri e luajtshme konsiderohet balanca e likuiditeteve në llogarinë bankare, dhe jo çelja e llogarisë bankare. Ndërkohë, në ankimin e Komisionerit Publik, pohohet se nuk ka të dhëna në momentin e krijimit të saj deri më 31.12.2004, që e bën të pamundur kontrollin/verifikimin e saj.

8.3.2. Pretendimi për krijim kursimesh apo pasurie për periudhën gusht 2003 – dhjetor 2004, nga një azilant/emigrant brenda 16 muajve pas mbërritjes, shkon përtej arsytimit logjik. Objekti optimal ishte mbulimi i shpenzimeve minimale jetike me të ardhurat e disponuara dhe ato të realizuara, konkretisht, me 20.000 USD të marra *cash* nga Shqipëria, dhe të ardhurat nga puna. Ka qenë në interesin e tij të deklarojë saktë të ardhurat e realizuara përpara pajisjes me numër pune, pasi si për çdo emigrant, situata e tij ekonomike ka qenë e lidhur ngushtë me statusin juridik. Integrimi ekonomik reflekton statusin juridik.

8.3.3. Vlerësimi i ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive në ShBA, duhet të fillojë nga viti 2005 deri në datën e krijimit të tyre, meqenëse në deklaratën *vetting* ka deklaruar të ardhura për periudhën 2005 – 2014. Pretendimi i Komisionerit se asnjëherë nuk ka deklaruar se pasuritë e

⁹ Subjekti referon në “Publication 501 [IRS], Cat. No. 15000U, “Exemptions, Standard, Deduction, and Filing Information for use in preparing 2004 Returns”.

krijua në ShBA kishin si burim të ardhurat e periudhës 2005-2014, nuk qëndron. Kolegji duhet t'u referohet të ardhurave të deklaruara në deklaratën *vetting* si burime të ligjshme, që janë pikërisht të ardhurat e deklaruara burim për krijimin e pasurisë shtëpi banimi në ShBA, atyre të periudhës 2005-2014¹⁰, pa shtrirë analizën për 2003-2004.

8.4. Rezultatet e analizës financiare kumulative të kryer në kushtet e regjimit të përbashkët familjar, tregojnë mjaftueshmëri të të ardhurave nga burime financiare të ligjshme, për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara gjatë periudhës gusht 2003 – 21.05.2012, pasi rezulton balancë pozitive në shumën 79.978 USD, ndryshe nga sa pretendon Komisioneri Publik dhe ONM-ja në rekomandim, e konkretisht në vlerën negative prej (-) 16.088 USD deri në fund të vitit 2012.

8.4.1. Rezultatet e analizës financiare kumulative për periudhën gusht 2003 – 31.12.2004, tregojnë pamundësi financiare për të justifikuar shpenzimet e kryera prej tij dhe anëtarëve të familjes në vlerën (-) 3.390 USD, nëse nuk merret në konsideratë asnjë e ardhur deri në muajin qershor 2004. Përbën mungesë logjike arsytimi, shprehet subjekti, se ai dhe familja kanë shpenzuar pa punuar për afërsisht 10 muaj. Për analizën financiare të kësaj periudhe, subjekti pretendon: (i) përfshirjen e të ardhurave të periudhës 13.07.2004 – 31.12.2004, si dhe të ardhurave të personit të lidhur dhe ato të personave të tjerë të lidhur. Ka provuar se ka qenë në marrëdhënie pune meqenëse ishte pajisur me dokumente që e lejonin të punonte duke filluar nga data 13.07.2004; (ii) rishikimin e shpenzimeve për qira, të cilat janë të dubluara pjesërisht në analizën e Komisionit, ku përveç përlllogaritjes si zë më vete të shpenzimeve të qirasë deklaruar prej tij, 1.500 USD/muaj për periudhën shtator 2003 – gusht 2010 dhe 1.800 USD/muaj për periudhën shtator 2010 – korrik 2012, i njëjti shpenzim është përlllogaritur edhe në përbërje të *indeksit poverty threshold*, i cili duhet të korrektohet duke i zbritur 35%-36% të peshës specifike që zë ky shpenzim në këtë indeks.

8.5. Rezulton e provuar se nuk plotësohen kushtet kumulative të përcaktuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, ku ligjvënësi ka parashikuar masën më të rëndë disiplinore, atë të shkarkimit nga detyra. Duke vlerësuar të njëjtat prova dhe fakte mbi të cilat është kryer hetimi i thelluar administrativ, sikurse Komisioni, Komisioneri Publik del në konkluzion të ndryshëm mbi të njëjtën bazë ligjore, duke vlerësuar në mënyrë të gabuar kriterin e pasurisë si “deklarim i pamjaftueshëm”. Nuk rezulton vlerësimi në nivel të papërshtatshëm i kriterit të figurës e, për pasojë, Komisioneri nuk duhej të arrinte në përfundim për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

8.6. Edhe nëse ekziston, pasaktësia është e paqëllimshme, formale dhe pa pasoja e nuk shoqërohet me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme financiare, pretendoi subjekti i rivlerësimit. Dokumentet janë të kohës dhe shërbejnë për hetim të thelluar të mundësive financiare të

¹⁰ Referuar vendimet e Kolegjit që u përkasin subjekteve të rivlerësimit N. Tavani (nr. 33/2021) dhe I. Gjoka (nr. 20/2022).

bashkëpronarëve për krijimin e pasurisë. Referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit¹¹, nuk ngrihen në nivelin që të kualifikohen sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, apo për pamjaftueshmëri në deklarim sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

8.7. Së bashku me parashtrimet, subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe disa dokumente, të cilat kërkoi të administrohen në cilësinë e provave të reja. Ndër to, katër (4) ishin shkarkime dhe printime të formularëve të akteve zyrtare të qeverisë federale të ShBA-së për azilantët, dy formularë nga Shërbimi i Shtetësisë dhe Imigracionit, USCIS, nga Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme [IRS, dy formularë], një (1) nga Departamenti i Taksave të Shtetit të New York-ut [një formular], një akt informues për emigrantët për përfitimin e stampave të ushqimit nga një organizatë joqeveritare [*Congressional Hunger Center*], si dhe dy broshura informative të botuara nga qeveria federale e ShBA-së, Administrata e Sigurimit Shoqëror [SSA], që detajojnë të drejtat që gëzojnë përfituesit e pensionit të thjeshtë dhe atij suplementar për shkaqe paaftësie ose mbushjes së moshës 65 vjeç, dhe hapat që duhen ndjekur, një kopje të ligjit që rregullon licencimin e agjentëve imobiliarë në shtetin e New York-ut, shkarkuar nga faqja zyrtare e internetit, si dhe tri (3) kopje të noterizuara dokumentesh, lëshuar në emër të tij që provojnë punësimin si agjent imobiliar nga data 31.12.2004, nga një aktivitet privat tjetër me datë 29.12.2004 dhe një kartë hyrjeje në Shoqatën e Juristëve të kontesë së New York-ut, e vlefshme deri më 31.12.2006.

8.8. Në kërkimet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit parashtroi se ankimi i ushtruar nga Komisioneri Publik është i pambështetur në ligj e në prova, është në shkelje të parimeve të gjyqimit të drejtë, të garantuar edhe nga neni 6 i KEDNJ-së¹², dhe në kundërshtim me këtë dispozitë, synohet të ngarkohet subjekti i rivlerësimit me një barrë të pakapërcyeshme të provave¹³. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit në përfundim, parashtroi argumentet e përmbledhura në vijim.

8.8.1. Ankimi kërkon shkarkimin e tij nga detyra për çështje që i përkasin një të kaluar të largët, 18-19 vite më parë, e që shoqërohen me pamundësinë objektive të sigurimit të dokumentacionit provues – parashikuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 – si dhe për parregullsi “të vogla formale” në përshkrimin e një pagese kredie të kryer nga i vëllai i subjektit të rivlerësimit. Analiza financiare mbi të cilën bazohet ankimi, i përket një periudhe kur nuk ka qenë gjyqtar dhe jetonte në ShBA, ku janë krijuar pasuritë me të ardhura të ligjshme. Komisioneri Publik ka ngritur pretendime të pabazuara; nuk identifikohet qartë baza ligjore konkrete mbi të cilën kërkohet ndryshimi i vendimit të Komisionit dhe shkarkimi i tij nga detyra, pasi nuk është cituar asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016. Nga përmbajtja e ankimit dhe e parashtrimeve të Komisionerit Publik, referimi në rekomandimin e ONM-së për ligj ekzistencën e shkaqeve si bazë për ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe shkarkimin e tij nga detyra.

¹¹ Subjekti referon vendimet e Kolegjit që u përkasin subjekteve të rivlerësimit S. Ngresi [JR nr. 37/2021], F. Islamaj [JR nr. 10/2022], I. Gjoka [JR nr. 20/2022], E. Shedula [JR nr. 35/2022] dhe V. Hoxha [JR nr. 36/2022].

¹² Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti referon vendimin e GjEDNJ-së në çështjen Othman (Abu Qatada) kundër Mbretërisë së Bashkuar, parag. 260.

¹³ Shih Dimitrov kundër Bullgarisë, Gogidite kundër Gjeorgjisë, parag. 107-108.

8.8.2. Për sa i përket rekomandimit të vëzhguesve të ONM-së, subjekti i rivlerësimit argumentoi se vëzhguesit ndërkombëtarë nuk i referohen legjislacionit të ShBA-së, ku ndodhen pasuritë, që përbën legjislacionin e zbatueshëm për kontrollin e tyre. Asnjë shkak ankimor nuk bazohet në gjetje të tyre [vëzhguesve]. Rekomandimi është ngritur në mungesë të hetimit administrativ proaktiv. Në seancën dëgjimore në Komision, subjekti ka theksuar pamundësinë objektive për të siguruar dokumentacion provues financiar për periudhën gusht 2003 – dhjetor 2004, si pasojë e përcaktimeve ligjore dhe funksionimit të organeve tatimore në ShBA. Vëzhguesit ndërkombëtarë duhet ta kërkonin aktivisht dhe drejtpërdrejt këtë informacion, duke ushtruar hapësirat e parashikuara në paragrafin 3, neni B, paragrafin 4, neni Ç i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikat 1 dhe 7 të nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, nën dritën dhe frymën e transparencës, drejtësisë dhe proporcionalitetit.

8.8.3. Kontrolli i pasurive të ndodhura në ShBA, duhet të kryhet sipas legjislacionit federal dhe shtetëror amerikan, të cilit nuk i është referuar as rekomandimi i ONM-së, dhe as ankimi i Komisionerit Publik. Ligji nr. 84/2016 referon në çdo ligj tjetër që mundëson përmbushjen me sukses të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

8.8.4. Në rekomandimin e ONM-së dhe në ankimin e Komisionerit Publik, nuk pranohet qëndrimi racional i Komisionit për fillimin e analizës financiare nga janari 2005. Prej tyre, nuk kuptohen rrethanat faktike dhe juridike, të cilat, në një interpretim të drejtë e logjik, do të sillnin të njëjtin rezultat në analizën financiare: mjaftueshmëri burimesh financiare për të përballuar shpenzimet jetike për periudhën gusht 2003 - dhjetor 2004, jo krijim pasurie, dhe në asnjë rast balancë negative.

8.8.5. Kolegji nuk duhet të marrë në konsideratë pretendimin e ngritur në ankim për ta konsideruar përgjegjës për mosruajtjen e dokumentacionit provues të periudhës gusht 2003 – dhjetor 2004, pasi bie ndesh me frymën e ligjit nr. 9049/2003¹⁴, detyrim i cili do t'u ngarkojë subjekteve të rivlerësimit vetëm pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016. Është e paarsyeshme të kërkohet të vërtetohen dhe njëkohësisht të zerohen të ardhurat për përballimin e shpenzimeve të jetesës për këtë periudhë. Ka provuar punësimin e tij, të vëllait dhe të babait, dhe në pamundësi objektive për të paraqitur dokumentacion lidhur me të ardhurat, ka referuar rregullimet ligjore të parashikuara në legjislacionin fiskal të shtetit amerikan¹⁵ dhe informacionin përkatës të publikuar për efektet e taksimit dhe mënyrën e pagimit të taksave për individët që nuk janë shtetas amerikanë dhe/ose emigrantë pa të drejtë punësimi.

8.8.6. Bazuar në nenin 45, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe në përputhje me jurisprudencën e tij për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës sipas alternativave të subjektit, Kolegji mban qëndrim në analizë garantiste, në mungesë të të dhënave të sakta zyrtare apo të dhënave domethënëse

¹⁴ “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2003/04/10/9049>.

¹⁵ *Federal [IRS] dhe shtetëror [New York State Department of Taxation and Finance]*.

kërkimore. Analiza financiare e korrektuar, sa i përket përlllogaritjes së dubluar të zërit *shpenzime qiraje*, edhe si zë më vete, sikundër deklaruar prej tij, edhe në përbërje të *indeksit poverty threshold*, rezulton me balancë pozitive në shumën 79.978 USD, ndryshe nga sa pretendohet në rekomandim dhe ankim, në (-) 16.088 USD deri në fund të vitit 2012, dhe me balancë pozitive në shumën 44.680 USD, për periudhën 2012 – 2015, ndryshe nga sa pretendohet në rekomandim dhe ankim, në (-) 24.593 USD në fund të vitit 2014 dhe (-) 21.140 USD në fund të vitit 2015.

8.8.7. Në përfundim, duke argumentuar se rekomandimi dhe ankimi nuk pasqyrojnë arsye të mjaftueshme faktike ose argumente ligjore që do të mbështesnin ndryshimin e vendimit të Komisionit dhënë ndaj tij, edhe nëse Kolegji konstaton ndonjë pasaktësi të vogël të karakterit formal e pa pasojë, subjekti i rivlerësimit u shpreh se shkarkimi i tij nga detyra nuk do të ishte proporcional, do të ishte në kundërshtim me frymën e ligjit nr. 84/2016, praktikën e Kolegjit, vendimet e GjEDNj-së¹⁶, dhe kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 519, datë 25.03.2022.

VI. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

i. Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

ii. Legjitimimi i ankuesit

10. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike,

¹⁶ Subjekti referon vendimet e GjEDNj-së në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*, paragrafët 85, 86, 88, dhe në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, paragrafi 403.

në prani të palëve, të cilat u zhvilluan në datat 07.02.2023 dhe 14.02.2023, ndërsa vendimi u shpall në datën 02.03.2023.

iv. *Kërkesa të subjektit gjatë dhe në funksion të gjykimit në Kolegj*

12. Më datë 23.01.2023, subjekti i rivlerësimit paraqiti kërkesë për përjashtimin e një anëtareje të trupit gjykues të caktuar për gjykimin e kësaj çështjeje me shortin e datës 09.06.2022. Kjo kërkesë u shqyrtua prej trupit gjykues të Kolegjit të shortuar më datë 24.01.2023, i cili disponoi me vendimin nr. 8, datë 02.02.2023, duke vendosur pranimin e saj. Trupi gjykues i referuar në hyrje të këtij vendimi, është ai i konfirmuar pas atij vendimi.
13. Në seancën publike të datës 07.02.2023, subjekti i rivlerësimit kërkoi që të përfaqësohej në gjykim, në prani dhe mungesë të tij, nga avokati Julian Mërtiri dhe nga znj. Katheleen Ann Imholz. Pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit dhe dokumentacionin bashkëlidhur, trupi gjykues vendosi të mos e pranojë kërkesën për përfaqësim nga znj. Imholz, për shkak se nga dokumentacioni i sjellë nga subjekti, nuk rezulton të ishin përmbushur kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar¹⁷. Në kushtet kur subjekti nuk provoi licencimin në Dhomën e Avokatisë së Republikës së Shqipërisë apo ekzistencën e një marrëdhënieje bashkëpunimi mes znj. Imholz dhe një zyre avokatie shqiptare, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se ajo [znj. Imholz] mund të asistonte subjektin e rivlerësimit dhe këshillonte pa ndonjë tagër formal përfaqësimi, dhe i mundësoi asaj praninë në sallën e gjykimit¹⁸. Më herët, përpara seancës publike, subjekti ishte informuar edhe *me shkrim* se përfaqësimi nga znj. Imholz kushtëzohej nga zbatimi i parashikimeve të nenit 64 të Kodit Civil, të pikës 3 të nenit 39 të ligjit 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të pikave 1 dhe 4 të nenit 23 të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, i cili rregullon qoftë përfaqësimin nga një avokat i licencuar në Shqipëri, ashtu edhe të atyre të licencuar jashtë saj¹⁹.
14. Pas çeljes së seancës publike të datës 07.02.2023, subjekti i rivlerësimit paraqiti kërkesë paraprake që Kolegji të përcaktonte legjislacionin e zbatueshëm në kuadër të këtij gjykimi, duke pretenduar se pret përgjigje për këtë çështje pas kërkesës dërguar Kolegjit në datën 26.01.2023.

¹⁷ Sipas kësaj dispozite që rregullon ushtrimin e avokatisë nga shtetas të huaj apo avokatë të licencuar jashtë Shqipërisë: “1. Profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë ka të drejtë ta ushtrojë edhe çdo shtetas shqiptar ose i huaj, që ka fituar titullin e avokatit në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, sipas rregullave të atij shteti anëtar dhe ka nënshkruar një kontratë bashkëpunimi me një studio avokatie në Republikën e Shqipërisë, e njohur dhe e regjistruar si e tillë në Dhomën e Avokatisë të Shqipërisë dhe në organet tatimore. [...]4. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, emri i avokatit të huaj vendoset pas emrit të studios së avokatisë të njohur dhe të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, shoqëruar me fjalët “në bashkëpunim me” [...]”.

¹⁸ Dokumentacioni i paraqitur për znj. I., përbëhej nga një fotokopje e diplomës në fakultetin juridik, një dokument nga një zyrë avokatore në New York, dhe fotokopje e lejes së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë.

¹⁹ Kthim përgjigje subjektit të rivlerësimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, me nr. prot. {***}, datë 03.02.2023.

14.1. Pasi dëgjoi edhe Komisionerin Publik për këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, i cili referoi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe legjislacionin ndihmës në funksion të procesit, trupi gjykues arsyetoi dhe u bëri me dije palëve siç shtjellohet në vijim.

14.2. Kjo kërkesë nuk bën pjesë në rrethin e kërkesave paraprake në kuptim të parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile. Nga ana tjetër, qartësisht, legjislacioni i zbatueshëm nga Kolegji përcaktohet nga Aneksi i Kushtetutës, ligji nr. 84/2016, si dhe çdo ligj tjetër që i vjen në ndihmë procesit.

14.3. Sa i përket pretendimit të subjektit se nuk ka marrë përgjigje për kërkesën e tij [datë 26.01.2023] lidhur me të njëjtën çështje, trupi gjykues theksoi se përmes dy kërkesave në fjalë, të adresuara me një përgjigje nga Kolegji, subjekti nuk ka kërkuar informacion për legjislacionin e zbatueshëm në gjykimin në Kolegj në kuadër të shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik, përkundrazi. Ndonëse në kërkesa, ligji nr. 10428, datë 02.06.2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private”, citohet si një ndër bazat ligjore, krahas një sërë dispozitash kushtetuese e ligjore të tjera, në përmbajtje kërkesa/t fokusohen në përbërjen e trupit gjykues, dhe më pas pyetje për përvojën profesionale të këshilltarëve të Njesisë së Shërbimit Ligjor të Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe mënyrën sesi funksionon ky institucion, sikurse edhe kërkon informacion për korrespondencën e këtyre të fundit me ONM-në. Është kjo arsyeja për të cilën në përgjigje, Kolegji ka referuar secilën nga pikat në një nënparagraf autonom në mënyrë shteruese. Në përgjigjen e kthyer, Kolegji ka informuar subjektin për secilën kërkesë, për sa kërkuar lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykimin në Kolegj.

14.4. Së fundmi, në seancën gjyqësore të datës 07.02.2023, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenet 45 dhe 49, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të marrë në cilësinë e provës ato dokumente të sjella nga subjekti [përmbledhur në paragrafin 8.7], që provonin fakte që lidhen me vetë subjektin e rivlerësimit, e konkretisht: licencën e agjentit imobiliar, të lëshuar në datën 31.12.2004, kopjen e kartës së identifikimit në biznesin privat, printuar më datë 29.12.2004. Të dyja këto akte janë cituar në pikën 10 të listës që subjekti i rivlerësimit kishte përcjellë me parashtrimet. Sa u përket dokumenteve të cituara në pikat 1 - 9 të së njëjtës listë, nën dritën e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të refuzojë marrjen e tyre në cilësinë e provës, pasi janë referuar në parashtrime dhe duke qenë të aksesueshme në burime të hapura, mund të aksesohen e vlerësohen drejtpërdrejt.

B. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit

15. Komisioneri Publik, sikurse edhe vëzhguesit ndërkombëtarë në rekomandim, fokusohen në tri nga pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit – përmbledhur më sipër. Në këtë funksion, përpos kërkesave për themelin e vlerësimit të pasurisë, Komisioneri Publik ka parashtruar edhe kërkesën

për t'i nënshtuar juridiksionit kontrollues të Kolegjit, dy çështje ligjore që derivojnë nga konkluzionet e Komisionit dhe ndikojnë mbi kontrollin e kriterit të pasurisë. Konkretisht, duke referuar rekomandimin e ONM-së, Komisioneri Publik konteston pretendimin e subjektit se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të dokumentuar të ardhurat e viteve 2003-2004 dhe shtrirjen e analizës financiare edhe në këto vite, ndryshe nga sa ka vepruar Komisioni. Për lehtësi reference, arsyetimi i trupit gjykues merr në analizë së pari, këto dy argumente, si dhe kundërargumentet e subjektit të rivlerësimit, e vijon me analizën e konkluzionet për shkaqet e ankimit që lidhen me themelin.

16. Lidhur me ligjin e zbatueshëm në procesin e rivlerësimit:

16.1. Siç është përmbledhur më sipër, subjekti i rivlerësimit argumentoi në parashtrimet në Kolegj dhe përpara çeljes së seancës se, nisur nga specifikat e rastit, kontrolli i pasurisë së tij nuk mund t'i nënshtrohej juridiksionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Sipas tij, meqenëse pasuritë objekt shqyrtimi janë krijuar jashtë Shqipërisë [dhe në kushtet e dyshtetësisë së tij], për kontrollin e tyre duhet të aplikohet legjislacioni i ShBA-së. Në këtë argument, subjekti referon ligjin nr. 10428, datë 02.06.2011, "Për të drejtën ndërkombëtare private". Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky argument, i ngritur së pari vetëm në gjykimin në Kolegj, është i pabazuar në ligj dhe i pakuptimtë. Referuar nenit 179/b të Kushtetutës, nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, kryerja e procedurave të rivlerësimit, me objekt hetimin dhe vlerësimin e pasurisë së subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, pavarësisht vendit ku janë krijuar dhe ndodhen²⁰, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit në deklaratën *vetting* dhe ato periodike. Nën dritën e këtij kuadri ligjor, subjektet e rivlerësimit që dëshirojnë të jenë pjesë e sistemit të drejtësisë, deklarojnë nën përgjegjësi pasuritë në pronësi e përdorim të tyre dhe burimin e krijimit, sikurse edhe duhet të shpjegojnë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre pasurive, si edhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

16.2. Në vijim të këtyre dispozitave, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar deklaratën e pasurisë dhe i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, për të tria kriteret. Jo vetëm që subjekti i rivlerësimit i është nënshtuar me vullnet të qartë procesit të rivlerësimit sipas këtyre bazave kushtetuese dhe ligjore, por, pasi është njohur me një balancë negative të konsiderueshme për krijimin e të njëjtave pasuri nga rezultatet e hetimit administrativ, ai ka paraqitur prapësimet e tij, në përmbushje të barrës së provës, bazuar mbi dispozitat e ligjit nr. 84/2016 dhe të ligjit nr. 44/2015, ndër të tjerë. Po ashtu, subjekti ka ushtruar të drejtat e tij në proces, duke kërkuar përfshirje të të ardhurave apo korrigjime të atyre të përfshira. Me fjalë të tjera, në asnjë nga këta hapa të ndjekur gjatë kontrollit të kriterit të pasurisë, nuk rezulton të ketë ekzistuar ndonjë paqartësi për ligjin e zbatueshëm për

²⁰ Ligji 84/2016, në nenin 3 "Përkufizime", në pikën 11 parashikon "“Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit."

pasuri të ndodhura jashtë Shqipërisë – që në mënyrë të shprehur janë pjesë e përkufizimit ligjor në fuqi ndër vite për çfarë duhej të kuptohej me pasuri qoftë në ligjin nr. 84/2016, apo me ligjin nr. 9049/2003 – e as nuk rezulton që subjekti të ketë kontestuar vlerësimin e kryer nga Komisioni. Përkundrazi, subjekti i rivlerësimit kërkoi në Kolegj lënien në fuqi të vendimit të Komisionit që e konfirmoi atë në detyrë, edhe për kriterin e vlerësimit pasuror. E njëjta situatë ka karakterizuar edhe ndërveprimin e subjektit me Komisionin, pas rriçeljes së hetimit për kriterin e pasurisë. Në kuadër të këtij momenti procedural, subjekti ka dhënë shpjegime për punësimin e tij në vitet 2003-2004 dhe për llogarinë bankare të hapur në vitin 2004 në ShBA dhe u është referuar burimeve të hapura federale amerikane²¹.

16.3. Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër, ndryshimi i qëndrimit të subjektit me parashtrimet në Kolegj, ku kontrollohet vendimi i Komisionit – me të cilin subjekti shpreh dakordësinë – duke pretenduar papritmas mungesë juridiksioni të institucioneve të rivlerësimit, dhe aplikimin e legjislacionit të huaj, vlerësohet si një përpjekje për të evituar t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor të shkaqeve të ankimit. Me vullnet të plotë, duke filluar nga 28.01.2017 – kur rezulton që subjekti të ketë plotësuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit *vetting* – e në vijim, përfshirë datën 25.03.2022, kur mori vendimin përfundimtar Komisioni, subjekti i rivlerësimit iu nënshtroa procesit të rivlerësimit sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, si magjistrat në detyrë, dhe me dakordësi me procesin për sa kohë u konfirmua në shkallën e parë me vendimin objekt ankimi. Në datën 02.03.2023, për herë të parë, dhe vetëm gjatë procesit në Kolegj, subjekti ngriti kërkesë për “përcaktimin e ligjit të zbatueshëm” dhe solli në mbështetje ligjin nr. 10428/2011, për të argumentuar që saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të tij nuk mund t'i nënshtrohen juridiksionit shqiptar.

16.4. Në përmbledhje e si konkluzion i sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se në kushtet kur vijimi i qëndrimit në detyrën e magjistratit për subjektin e rivlerësimit kushtëzohet nga, ndër të tjera, përmbushja e detyrimit kushtetues për saktësi e plotshmëri deklarimesh për kriterin e kontrollit të pasurisë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për përjashtim nga kontrolli i pasurive të tij jashtë vendit, është i pabazuar. Fakti që ky pretendim është ngritur për herë të parë gjatë (6) vite pasi subjekti i është nënshtroar procesit me vullnet të plotë, dhe vetëm kur vendimi i Komisionit iu nënshtroa kontrollit të Kolegjit, dëshmon se bazohet [pretendimi] në shkaqe situacionale dhe jo parimore apo të interpretimit të ligjit nga ai vetë. Së dyti, dhe si *obiter dictum*, siç shtjellohet gjerësisht në arsyetimin për themelin e shkaqeve të ankimit, si në pretendimet e Komisionerit Publik, ashtu edhe në arsyetimin e kryer në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit nga Kolegji, gjatë procesit të rivlerësimit në *asnjë* moment dhe në *asnjë* formë nuk rezulton të jenë kontestuar veprimet juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit apo të drejtat reale të fituara prej tij mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të fituara dhe krijuara në ShBA. Veprimet juridike të kryera në këtë kuadër nga subjekti, si dhe procedurat e ndjekura nga personat juridikë e individët e përfshirë në këto transaksione, nuk kanë qenë asnjëherë objekt kontestimi në

²¹ [Transcript Types and Ways to Order Them/Internal Revenue Service \(irs.gov\)](#).

shkaqet e ankimit, apo në vlerësimin e kryer nga Kolegji, sikurse as nga Komisioni. Për pasojë, në kushtet kur kuadri ligjor që normon rivlerësimin rezulton qartësisht në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10428/2011 – nenet 36-38, ndër të tjera – trupi gjykues e gjen këtë pretendim të subjektit alogjik, parë edhe në nivel parimor, përpos atij konkret.

17. *Pretendimet për periudhën kohore që duhet t'i nënshtrohet kontrollit të pasurisë:*

17.1. Pretendimet e subjektit në Kolegj për aplikim të legjislacionit amerikan, në thelb konsistojnë në prapësime kundër shkakut të ankimit për pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme, argumentuar nga Komisioneri Publik në pikën 17.6.2 të ankimit, dhe lidhen me tri pasuritë objekt ankimi. Ndërsa konkluzionet e Kolegjit për themelin e kontrollit të këtyre pasurive shtjellohen më poshtë, në vijim të arsytimit të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi konkluzionin e Komisionit dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit për të ardhurat e fituara në ShBA në periudhën menjëherë pasi ka udhëtuar atje, shtator 2003 deri më 31.12.2004. Komisioneri Publik argumenton se në kushtet kur subjekti ka deklaruar si burim krijimi të pasurive të ardhurat përpara fillimit të detyrës në vitin 2014, ndryshe nga sa ka vepruar Komisioni, analiza duhet të kryhet duke nisur nga viti 2003. Pamundësia financiare për të paguar këstin e parë dhe të dytë të pagesës së shtëpisë [shtjelluar në vijim] do të ishte në balancën negative prej (-) 16.000 USD.

17.2. Nga aktet e sjella, subjekti i rivlerësimit rezulton që të ketë fituar statusin e azilantit në datën 13.07.2004. Më herët, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur detyrën e gjyqtarit, nga viti 1999 deri në dhënien e dorëheqjes, “për shkaqe objektive”, në datën 26.04.2004, pasi ishte larguar drejt ShBA-së në gusht 2003²². Nga përmbajtja e letrës së dorëheqjes, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka njoftuar KLD-në për faktin që qëndrimi i tij do të zgjaste, nuk ka kërkuar leje që përkonte me qëndrim afatgjatë dhe se planifikonte të vazhdonte studime të thelluara në fushën e së drejtës. Me efekt nga data 25.05.2004, KLD-ja e ka liruar nga detyra subjektin e rivlerësimit.

17.3. Kronologjia e veprimeve të mësipërme paraqet relevancë në kontekstin e faktit që duke filluar nga *qershori 2003*, ndërsa subjekti ishte në detyrë dhe ende fizikisht në Shqipëri, hyri në fuqi ligji nr. 9049/2003. Mbi bazën e nenit 3, germa “d” e këtij ligji, subjekti i rivlerësimit do të duhet të kishte deklaruar pasuritë dhe interesat privatë, deri më 31 mars të vitit 2004. Nuk rezulton që subjekti ta ketë zbatuar këtë detyrim ligjor, ndonëse dorëheqja daton 26 prill 2004 dhe vendimi i lirimt një muaj më pas. Nga ana tjetër, akti i dorëheqjes paraqet rëndësi në disa aspekte. Së pari, parë në kontekstin e procesit të rivlerësimit, rezulton se ndërsa subjekti në prapësime dhe gjykimin në Kolegj ka pretenduar se ka qenë i punësuar edhe përpara periudhës për të cilën ka sjellë dokumentacion provues, e konkretisht nga viti 2005 e më pas, nga korrespondenca e tij me KLD-në, rezulton se subjekti ka qenë për vizitë, për qëllime studimi, dhe ka munguar të kërkojë leje afatgjatë pasi ishte sëmure rëndë, fakt që ka pamundësuar kërkesën për zgjatje të lejes nga KLD-ja. Me fjalë të tjera, ndërsa në procesin e rivlerësimit subjekti pretendon të ketë qenë aktivisht i

²² Referuar kërkesës për dorëheqje të paraqitur prej tij me shkrim, pranuar në KLD më 26.04.2005, pjesë e fashikujve të Komisionit.

punësuar pak pas hyrjes në ShBA – ndërkohë që zyrtarisht ishte ende i emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, deri më 25.05.2004 – në procesin e dorëheqjes pranë KLD-së, në prill 2004 [sikurse edhe në kërkesën për rëmërim pas 10 vjetësh, në 12.05.2014] – subjekti ka shprehur pamundësi shëndetësore serioze, të tilla që kanë penguar jo vetëm kthimin e tij në detyrë, por edhe kërkimin e lejes për qëndrim të gjatë apo shkëputjen e marrëdhënieve të punës.

17.4. Duke lënë mënjanë problemet me natyrë të përgjegjesisë profesionale që dalin në pah nga sa rezulton nga ky pohim, fakte të lëna në heshtje nga KLD-ja, minimalisht në momentin e rëmërimin në vitin 2014 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë²³, subjekti i rivlerësimit paraqitet i pasinqertë, në versionin e pretenduar përpara KLD-së ose përpara institucioneve të rivlerësimit. Konkretisht, nëse pranohet versioni i fakteve të pretenduara në procesin e rivlerësimit, subjekti ka qenë i pasinqertë kur ka pretenduar se ishte përballuar *personalisht me probleme serioze shëndetësore*, për shkak të të cilave nuk ka komunikuar në kohë për të kërkuar leje apo marrë masat për të paraqitur dorëheqjen²⁴ – siç rezulton nga pohimi i tij në aktin e dorëheqjes – por ka dështuar të përmbushë edhe detyrimin ligjor të deklarimit të pasurive dhe të interesave privatë për shkak të ligjit nr. 9049/2003, si magjistrat. Nga ana tjetër, nëse pranohet versioni i paraqitur KLD-së, për arsyet që kanë pamundësuar kërkimin e lejes për tetë (8) muaj apo gjendje shëndetësore të tillë që ka vendosur në plan detyësor plotësimin e detyrimeve ligjore në vitin 2004, pretendimi i punësimit që në vitin 2003 në ShBA, apo gjithsesi përpara korrikut 2004, kur ka marrë autorizimin për punësim, është jobindës dhe me probleme në raport me të vërtetën.

17.5. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në kushtet kur subjekti në fakt ka aplikuar dhe fituar azil politik në ShBA, asnjë nga versionet e mësipërme mund të mos përkojë me realitetin. Për rrjedhojë, aktet dokumentare marrin peshë veçanërisht të shtuar në funksion të kontrollit të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Nga kronologjia e ngjarjeve të dokumentuara, rezulton se edhe akti i dorëheqjes në fund të prillit 2004, përkon me pritshmëritë e subjektit për një përgjigje pozitive për kërkesën për azil politik, siç dëshmohet edhe nga përgjigjja pozitive e marrë prej të atit të subjektit në maj 2004. Nuk rezulton ndërkohë që subjekti të ketë plotësuar një deklaratë në funksion të ligjit

²³Kërkesë e dërguar KLD-së më 12.05.2014, me anën e së cilës subjekti i rivlerësimit ka aplikuar për emërim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke argumentuar, ndër të tjera, arsyet e udhëtimit në ShBA: “me qëllimin e mirë për të thelluar njohuritë [...] në lëmin e drejtësisë [...]”. Rezulton që subjekti në fakt ka përfituar leje qëndrimi si azilant politik, fakt që nuk ka gjetur pasqyrim në korrespondencat me KLD-në, lidhur me lirin nga detyra e rëmërimin.

²⁴Referuar letrës së dorëheqjes së dërguar KLD-së, riprodhuar tekstualisht [*gabimet janë të autorit*]: “[...] Ne muajin Gusht të vitit 2003 kam ardhur në New York, [...] kam aplikuar për "Master Degree" pranë dy universiteteve këtu në N.Y., atij të [...], nga ku përgjigje pozitive kam nga të dy këto universitete. Nderkohe që pritej kthimi i përgjigjeve nga universitetet respektive [...], **personalisht** kam patur disa probleme serioze shëndetësore. Për shkak të këtyre problemeve **te cilat kanë vazhduar për një periudhë relativisht të gjatë**, nuk më është dhënë mundësia e ndjekjes së procedurave normale **te parashtrimit në kohë të një kerkese për akordim lejeje apo në të kundert të paraqitjes në detyrë**. Në këto kushte, do të kerkoja në pamundësi të paraqitjes time fizike, në pamundësi të akordimit nga ana juaj të një leje si rezultat i kalimit të një koke relativisht të gjatë, të pranoni dorëheqjen time nga detyra e gjyqarit në pamundësi objektive të përmbushjes së kesaj detyre. Pranimi nga ana juaj i kesaj dorëheqje të kondicionuar nga rrethana objektive do të më jepte mundësinë që **ne një kthim sa më të shpejt të mundshëm të rikthehem në rrallet e gjyqsorit**. Mendoj se thellimi i njohurive, marrja e kultures juridike me të mirë të mundshme do të ndikonte ndjeshëm në rritjen e kontributit tim në sistemin tone gjyqsor, në dhenien e drejtësisë dhe forcimin e shtetit të drejtës [...]”.

nr. 9049/2003, ndonëse deri në afatin e përcaktuar me ligj, 31 mars 2004, dorëheqja nuk ishte dhënë dhe ai ishte efektivisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Deklarata e parë në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, është ajo e vitit 2014.

17.6. Në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën para fillimit të detyrës në 2014, me rikthimin në gjyqësorin shqiptar, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të katër pasurive të krijuara në ShBA, të ardhura nga paga/kursime të akumuluar para përpara emërimit në detyrën e gjyqtarit në vitin 2014. Në këto shpjegime, nuk rezulton të jetë kufizuar specifikisht periudha gjatë së cilës janë gjeneruar të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive. Me fjalë të tjera, subjekti nuk ka veçuar vitet 2003-2004, si periudhë gjatë së cilës nuk janë gjeneruar të ardhura.

17.7. Në konkluzion të analizës së fakteve të mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kontrolli i pasurisë së tij duhet të përjashtojë periudhën kohore përpara vitit 2005, sikurse ka vepruar edhe Komisioni, është i pabazuar. Ky vlerësim merr për bazë disa aspekte. Së pari, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrën e gjyqtarit për pesë vite përpara dorëheqjes dhe lirimit nga detyra, me efekt nga maji 2004. Në këtë drejtim, trupi gjykues sjell në vëmendje që plotësimi i deklaratës për vitin 2003 apo pas largimit nga detyra, sipas ligjit nr. 9049/2003, detyrime të cilat subjekti ka dështuar t'i kryejë, merr rëndësi të veçantë jo vetëm si ilustrim i qasjes së tij ndaj përgjegjësive profesionale, por do të kishte peshë në këtë proces nën dritën e dispozitave të nenit 32, pika 5, për vlerën provuese të deklaratave ndër vite në procesin e rivlerësimit. Së dyti, në të dyja deklaratimet, atë të vitit 2014, si dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka specifikuar si burim krijimi të pasurive, të ardhurat përpara vitit 2014 – që nënkupton nga viti kur subjekti ka fituar bursë nga Shkolla e Magjistraturës, deri në fillimin e detyrës sërish si gjyqtar. Nëse të ardhurat përpara vitit 2005 nuk kanë gjeneruar pasuritë e deklaruar, subjekti do të duhet të kishte identifikuar së paku në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, kohën kur janë gjeneruar të ardhurat.

17.8. Mbi të gjitha, në kushtet kur subjekti ka kryer detyrën e gjyqtarit për të paktën katër (4) vite përpara vitit 2005, pretendimi i tij se periudha deri në vitin 2004, nuk duhet të jetë pjesë e procesit të rivlerësimit, sidomos parë nën dritën e neglizhencës së tij për të dorëzuar deklaratën e parë deri në mars 2004, është i pabazuar. Nga leximi harmonik i përcaktimit të pasurive që janë objekt deklarimi, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe akteve nënligjore të dala për zbatimin e tyre²⁵, nuk rezulton dallim për shkak të kohës së krijimit në nivel parimor. Konkretisht, sipas shtojcës nr. 2 [faqe 5] të ligjit, sikurse edhe në aktet nënligjore në zbatim të tyre, ligjbërësi nuk rezulton të ketë vendosur një kufi kohor që përkon me periudhën përpara detyrës apo gjatë saj. Formulari në mënyrë specifike udhëzon subjektet e rivlerësimit të deklarojnë:

“[...] Të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat

²⁵ Udhëzimi nr. 4095/2016 i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, ndër të tjera, në pikat 7, 20, 21 dhe 22.

reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur”.

17.9. Në zbatim të sa më sipër, Kolegji ka shqyrtuar vendimet e Komisionit në funksion të kontrollit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit, përfshirë edhe për periudha të ndërmjetme, ndërsa ata kanë qenë shkëputur nga sistemi i drejtësisë²⁶. Në këtë kuadër, analiza e Kolegjit, përpos deklaratës së pasurisë, është bazuar sipas rastit, duke marrë në analizë si provë, deklaratat periodike vjetore, sikurse edhe ato pas lënies së detyrës. Për këto arsye, është i pabazuar në ligj konkluzioni i Komisionit për të përjashtuar nga analiza dy vite, sikurse është i pabazuar edhe kërkimi i subjektit të rivlerësimit që analiza financiare nuk duhet të përfshijë periudhën kohore përpara vitit 2005.

17.10. Për sa më sipër, nga një analizë e pretendimeve dhe e shpjegimeve të subjektit lidhur me peshën e të ardhurave të viteve 2003-2004 në krijimin e pasurive në ShBA, trupi gjykues konstaton kundërtënie të konsiderueshme mes sa subjekti ka pretenduar në prapësim të ankimit të Komisionerit Publik në seancë gjyqësore në Kolegji me prapësimet në rezultatet e hetimit administrativ në Komision. Konkretisht, në Kolegji subjekti ka argumentuar se është *përtej arsytimit logjik* të konkludohet për krijim pasurie në këtë periudhë, pasi objektivi ishte *të mund të mbulonte shpenzimet minimale jetike me të ardhurat e disponuara dhe ato të realizuara*. Në këtë kontekst, subjekti deklaroi edhe vlerën 20.000 USD *të marra cash nga Shqipëria dhe të ardhurat nga puna*²⁷. Ndryshe nga ky pretendim në Kolegji, në përmbushje të barrës së provës për balancën negative për periudhën 2005 – 21.05.2012, për njërin prej pasurive të krijuara në ShBA në vitin 2005, autoveturë BMW, në Komision subjekti ka deklaruar se automjeti *nuk* ishte domosdoshmëri falë transportit publik, por është blerë *për nevoja ngushtësisht familjare*: “[...] gjatë viteve 2003-2004 kemi realizuar të ardhura të mjaftueshme për të pasur mundësi për blerjen e automjetit në vlerën 13.000 USD [...]”. Më tej, subjekti ka pretenduar “[...] edhe gjatë kësaj periudhe unë kam bërë punë të ndryshme duke përfutur të ardhura nga të cilat kisha mundësi të kurseja [...]”²⁸

17.11. Më tej, trupi gjykues vëren që subjekti është sërish inkohorent në pretendime për sa i përket kësaj periudhe kohore, në përpjekje për të paraqitur faktet në favor të situatës së tij, qoftë edhe duke ndjekur qasje alogjike. Konkretisht, subjekti përpiqet të argumentojë për të njëjtën periudhë kohore që situata e të ardhurave të pretenduara, siç është paraqitur prej tij në Komision, ka përbërë gjithësi argument që në analizën financiare të vitit 2005, të *mos përfshihej* shpenzimi për blerjen e automjetit. Me fjalë të tjera, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Komisionit mospërfshirjen e një shpenzimi të konfirmuar, të kryer sipas çmimit të deklaruar prej atij vetë, në sja të të ardhurave

²⁶ Shih, ndër të tjera, vendimet e Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit A. Zeneli [JR nr. 2/2019], si dhe vendimin që i përket çështjes së rivlerësimit të subjektit S. Ngresi [JR nr. 37/2021].

²⁷ Shih prapësimet me shkrim dhe në seancë gjyqësore publike në Kolegji, datë 27.02.2023, përmbledhur më sipër në paragrafin 8.3.2.

²⁸ Shih shpjegimet e subjektit në faqen 32 të prapësimeve për rezultatet e hetimit administrativ.

që, sipas tij, ishin të mjaftueshme për të investuar në një automjet që “nuk ishte domosdoshmëri”, pasi vetëm kështu do të mundësohej “dhënia e një vlere sa më të drejtë dhe objektive të gjendjes së llogarive bankare deri në datë 21.05.2015”.

17.12. Sa më sipër, nën dritën e përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 e në vijim të ligjit nr. 84/2016, dhe në kushtet që konstatoi qëndrime kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i vlerësoi të pabazuara pretendimet e subjektit në Kolegj për të përjashtuar harkun kohor të viteve 2003 – 2004 nga analiza financiare. Po ashtu, edhe pretendimet e tjera deklarative të subjektit të rivlerësimit për punësim, përpos sa provohet me dokumentacion, siç arsyetohet në detaj në vijim, apo për të pranuar mbulimin e shpenzimeve minimale të jetesës, ekskluzivisht për periudhën kohore në fjalë, u gjetën jobindëse. Pretendimet e subjektit rezultojnë të jenë të ndryshme, në funksion të mbështetjes së rrethanave kohore e ligjore të ndryshme.

17.13. Së fundmi, trupi gjykues i gjeti pa vlerë provuese aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, pranuar në cilësinë e provës [shih edhe në paragrafin 14.4], për disa arsye. Së pari, përpos faktit që vetë subjekti nuk ka dhënë informacion për shumën e të ardhurave të pretenduara të fituara, as licenca e ushtrimit të aktivitetit si agent imobiliar nuk sjell vlerë të shtuar, për sa kohë tregon që duke filluar vetëm nga 1 janari 2005, subjekti ishte i licencuar të ushtronte këtë aktivitet, ndërkohë që janë dy vitet pararendëse në pyetje, dhe nuk provon sasinë e të ardhurave të gjeneruara si rezultat i këtij licencimi. Së dyti, nga burime të hapura, rezulton që personi juridik me të cilin subjekti është licencuar të punojë, rezulton të jetë regjistruar nga autoritetet e shtetit të New York-ut vetëm në maj 2004²⁹. Me fjalë të tjera, agjencia imobiliare ka filluar të ekzistojë vetëm shtatë (7) muaj përpara datës nga kur fillon vlefshmëria e licencës për ushtrimin e aktivitetit, lëshuar në emër të subjektit. Për pasojë, edhe në nivel teorik, përjashtohet mundësia e punësimit të subjektit apo e fitimit të të ardhurave për periudhën shtator 2003 e deri në maj 2004, minimalisht. Aktet e tjera të sjella nga subjekti – cituar në fund të paragrafit 8.7³⁰, u gjetën po ashtu pa asnjë vlerë provuese në drejtim të sasisë së të ardhurave që mund të jenë gjeneruar, apo edhe si tregues indirekt i një aktiviteti që gjeneron të ardhura.

17.14. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje se paraqitja e një dokumenti që provon të drejtat e hyrjes në një institucion apo licencimin, në kushtet kur vetë subjekti në asnjë moment nuk ka paraqitur një vlerë qoftë edhe deklarative të të ardhurave të fituara apo të ketë dëshmuar përpjekje për të mbledhur dokumentacion qoftë edhe në nivel indicieje të punësimit gjatë kësaj periudhe kohore, ndërsa nga ana tjetër në prill 2004, ka pretenduar përpara KLD-së se kishte pasur probleme shëndetësore serioze, krijon një panoramë faktesh në të cilën pretendimet e krijimit të të ardhurave, janë të pabesueshme.

²⁹ Shih: https://opencorporates.com/companies/us_ny/3056347. AMJ Fortune Realty Corp rezulton e regjistruar për herë të parë në 21 maj 2004.

³⁰ Kopje e noterizuar e një karte hyrjeje, lëshuar nga një aktivitet privat tjetër, Washington Inventory Services, me datë vlefshmërie nga 29.12.2004 dhe një kartë hyrjeje në Shoqatën e Juristëve të kontesë së New York-ut me vlefshmëri deri në 31.12.2006.

18. Pretendimet për pamundësi objektive për të paraqitur dokumentacion mbështetës:

18.1. Komisioneri Publik argumenton se subjekti i rivlerësimit nuk ishte në kushtet e pamundësisë objektive³¹ në kohën kur ka dorëzuar *deklaratën para fillimit të detyrës*, më 08.08.2014 (DPFD), për të paraqitur dokumentacion për pasuritë e ndodhura në ShBA. Përkundër këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit argumenton që me dorëzimin e dokumentacionit bashkëlidhur DPFD-së 2014, pranë ILDKPKI-së, ka përmbushur detyrimin ligjor për të depozituar dokumentacionin që provon burimet e krijimit të pasurive në pronësi e posedim, përfshirë edhe për periudhën kohore 2003 – 2004. Në analizë të këtyre pretendimeve dhe akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, përpos konfuzë dhe me kundërthënie, janë edhe të pabazuara.

18.2. Së pari, në kushtet kur në deklaratën *vetting*, për pasuritë e ndodhura në ShBA, burim krijimi janë deklaruar "të ardhurat nga pagat", sikurse arsyetuar më sipër, subjekti ka pasur detyrimin për të specifikuar *shumën* e të ardhurave të fituara prej tij dhe personit/personave të lidhur, si edhe për të paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me to, në zbatim të kuadrit kushtetues e ligjor të rivlerësimit dhe udhëzimit të Inspektorit të ILDKPKI-së³². Pretendimi se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentacionin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, parashikuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të ardhurat e viteve 2003-2004, jo vetëm që nuk e çliron subjektin nga detyrimi *minimalisht për deklarimin e të ardhurave në sasi*, por edhe nuk gjen zbatim në rrethanat konkrete, pasi subjekti nuk ka provuar në asnjë formë se dokumenti nuk mund të përftohet, për arsye të cilat janë përtej kontrollit të subjektit të rivlerësimit. Provueshmëria e këtij aspekti nga subjekti i rivlerësimit, është kusht i përcaktuar shprehimisht nga ligjbërësi, mbi bazën e të cilit institucionet e rivlerësimit legjitimohen të konstatojnë pamundësinë objektive. Në këtë kontekst, trupi gjykues vëren se edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe në procesin në Kolegji, se marrja e dokumentacionit në vitin 2014 do të kërkonte kohë të gjatë, disa muaj, nuk përbën provim të pamundësisë objektive apo përpjekje të kryer prej tij në kushtet kur subjekti, edhe nëse pranohet sa ka argumentuar, është kufizuar me gjetjen e kohëzgjatjes që do të nevojitej për tërheqjen e informacionit, pa e pasuar me veprimet e tij të mëtjshme.

18.3. Nga ana tjetër, fakti që në deklaratën *vetting*, subjekti nuk ka deklaruar të ardhura *vetëm* për periudhën 2003-2004, *nuk* mund të passjellë logjikisht gjendjen e pamundësisë objektive. Ky fakt

³¹ Parashikuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84.2012: "[...] 2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor [...]".

³² Udhëzimi me nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, në pikën 20 të tij parashikon: "Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga pagat, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor për të ardhurat neto nga institucioni pranë të cilit kanë qenë dhe janë të punësuar subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë".

passjell *vetëm* prezumimin e mungesës së të ardhurave – siç është trajtuar gjerësisht edhe më sipër – ose, që subjekti, me vullnet të lirë, ka zgjedhur të mos deklarojë të ardhura për atë hark kohor. Më pas, gjatë procesit, subjekti ka kërkuar që të pranohet pretendimi i tij deklarativ – për të ardhura për të mbuluar nivel bazik jetese, apo për krijim edhe pasurie [automjeti], të cilësuar jo të domosdoshme – që nënkupton kontradiktë në kushtet kur dëshmon krijim pasurish përtej nivelit bazik të jetesës. Të gjitha këto kundërthënie sillen në vëmendje për të ilustruar inkoherencën e pretendimeve të subjektit, ndërkohë që kushtet e përcaktuara qartë nga ligji për të konkluduar pamundësinë objektive, nuk janë përmbushur në ndonjë formë.

18.4. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti është kontradiktor pasi shpjegimet e tij, në faza të ndryshme të procesit, bien ndesh mes tyre. Së dyti, pretendimi që gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të sjellë dokumentacion për vitet 2003-2004, është i pabazuar. Në kushtet kur në asnjë moment gjatë procesit apo më herët, subjekti as nuk dha një vlerë të të ardhurave, duke abstraguuar nga fakti që as nuk u provua kjo vlerë, sikurse as punësimi, rrethana që përjashtojnë automatikisht edhe provueshmërinë e ligjshmërisë së tyre, nën dritën e kërkesave të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016³³, pretendimi për pamundësi objektive rezulton një ushtrim logjik i pamundur. Së fundmi dhe me peshë kryesore në këtë aspekt, pretendimet e subjektit për pamundësi marrjeje dokumentacioni përpara fillimit të detyrës, në vitin 2014, mbeti krejtësisht deklarativ. Qoftë në atë periudhë kohore, qoftë më pas, subjekti nuk ka përmbushur kushtin e vendosur nga neni 32, pika 2 e ligjit – të provojë se ka kërkuar dokumentacion. Referimi në udhëzimet e përgjithshme të Shërbimit të të Ardhurave të Brendshme të ShBA-së [IRS], se të dhënat mbahen për periudha të caktuara kohore, tregon vetëm që ky autoritet federal, në vijim të politikave të tij të menaxhimit të akteve, ruan deklaratimet e taksave për periudha të caktuara kohore. Së fundmi, në kushtet kur subjekti ka qenë në gjendje të sillte kopje të deklaratimeve, duke filluar nga viti 2005 [nga kontabilistja e licencuar, e kontraktuar prej tij dhe personit të lidhur], duket i pasinqartë pretendimi se këto akte nuk gjendeshin vetëm për periudhën 2003-2004, nën dritën e gjithë fakteve të arsyetuara në këtë vendim. I vetmi argument logjik që bën kuptim në këto rrethana, është që subjekti nuk ka pasur të ardhura të deklarueshme e, për pasojë, nuk ka kryer deklaratim taksash për këto vite.

18.5. Në vijim të sa më sipër, edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioneri Publik krijon konfuzion mes detyrimit të tij [subjektit] për paraqitje të dokumentacionit provues të pasurive dhe burimeve të krijimit të tyre, është i pakuptimtë. Siç është arsyetuar edhe më sipër, është vetë subjekti konfuz në kërkesat e tij, ose synon të krijojë konfuzion në mbështetje të pretendimeve të tij. Po ashtu, subjekti nuk provoi pamundësinë e tij objektive për të poseduar dokumentacionin që provonte të ardhura për disa vite. Duke lënë mënjanë argumentet e sipërshtjelluara, që lidhen me faktin që kjo periudhë kohore përkon edhe me kohën kur subjekti ishte ende në detyrë në Shqipëri, pretendimet e ngritura u vlerësuan nga trupi gjykues si përpjekje

³³ Ligji nr. 84/2016, në nenin 3, pika 19 parashikon: “‘Të ardhura të ligjshme’ janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin ‘Mbi tatimin mbi të ardhurat’”.

për të mos ia nënshtruar kontrollit vite të caktuara të ndërmjetme, ndonëse përkojnë me krijimin e të paktën një pasurie [automjet].

B.1 Lidhur me pasuritë e deklaruara

*1. Shtëpi banimi me sipërfaqe 180 m², {***}, {***}, New York {***}, ShBA (në vijim “pasuria shtëpi banimi në ShBA”)*

19. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë vlerësim, duke përfshirë në tërësi rekomandimin e ONM-së, Komisioneri Publik fokusohet në faktin që subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar vlerën e plotë të kredisë që ka shërbyer si burim deri në tetor 2021, gjatë procesit të hetimit administrativ, me pyetësorin nr. 3. Komisioneri argumenton se deklarimi i subjektit për vlerën e saktë të kredisë, nga W. F. Bank, marrë në vitin 2012, është i pasaktë qoftë në deklaratën para fillimit të detyrës apo në deklaratën e pasurisë [vetting], sikurse është i pasaktë e i pamjaftueshëm deklarimi për këstin e dytë prej 46.680 USD.

19.1. Në rezultatet e hetimit, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve lidhur me:

- deklarimin e pasaktë në DPDFD-në e vitit 2014, si dhe në pyetësorin standard, në lidhje me shumën e kredisë bankare të marrë për blerjen e banesës në ShBA, duke e deklaruar atë në shumën 261.000 USD, pra në një vlerë më të madhe se vlera e aprovuar dhe e disbursuar e kredisë prej 217.500 USD;
- mosdeklarimin e pagesës së shumës prej 46.638,43 USD, paguar prej tij dhe vëllait të tij, për blerjen e banesës në ShBA, duke u mjaftuar vetëm me deklarimin e pagesës së paradhënies në shumën 29.000 USD; si dhe
- mungesën e të ardhurave të ligjshme të mjaftueshme për të paguar në total shumën prej 75.638,43 USD, e cila ka shërbyer si *downpayment*/ pagesë e kryer brenda datës 21.5.2012.

19.2. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se: (i) deklarimi i kredisë së marrë nga W. F. Bank, si një nga burimet e krijimit të pasurisë në vlerën 261.000 USD, përkundër shumës prej 217.500 USD, në DPDFD-në e vitit 2014 (dhe pyetësorin standard), është bërë duke iu referuar përcaktimit të kontratës së shitjes së datës 17.2.2012, ndërkohë që në rubrikën “Detyrime financiare” të DPV-së për vitin 2014, subjekti ka deklaruar saktësisht kredinë, në vlerën 217.500 USD; (ii) mosdeklarimi në DPDFD-në e vitit 2014, por edhe në vijim në pyetësorin standard, i shumës prej 46.638 USD, paguar nga vëllai i subjektit në datën 21.5.2012, nuk ka pasur për qëllim fshehjen e kësaj pagese. Sipas Komisionit, ky deklarim i subjektit ishte “për të qenë në të njëjtën linjë me kontratën e shitjes më datë 17.2.2012”. Këtë konkluzion, Komisioni e mbështet në argumentet që vijnë: (i) faktin që pagesa është kryer [me çek] në rrugë bankare; (ii) “u vërtetua” [sipas Komisionit] se subjekti dhe vëllai i tij kanë pasur të ardhura të ligjshme për të kryer këtë pagesë

brenda datës 21.5.2012; (iii) pasaktësitë e evidentuara nuk kanë sjellë asnjë pasojë, e nuk mund të përbëjnë shkak për penalizim të subjektit. Sipas Komisionit, ky vlerësim pasqyron qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit dhe praktikën e Komisionit.

19.3. Në parashtrimet e tij në Kolegj, subjekti i rivlerësimit argumentoi se ndonëse formalisht nuk ka pasqyruar saktë të dhënat, nuk ka kryer deklaram kontradiktor. Të dhënat, sipas subjektit, evidentohen nga dokumentacioni i depozituar bashkëlidhur deklaratës dhe se i është referuar kontratës së shitjes së pasurisë, ku specifikohet çmimi prej 290.000 USD dhe detajet për këstet. Nuk i është referuar kontratës së kredisë, ku specifikohet ekzaktësisht që banka do të financonte vetëm 217.500 USD, bazuar në situatën financiare të dy bashkëbërësve, dhe jo 261.000 USD, si specifikuar në kontratën e shitjes. Në DPDFD-në në vitin 2014, deklarimi i tij konsiston në pjesën e detyrimeve që ishin shlyer prej tij për finalizimin e kontratës (çmimin e banesës prej 290.000 USD dhe shumën prej 29.000 USD likuiduar prej tij), dhe në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ka përzier të dhënat e kontratës së shitjes me ato të kontratës së kredisë. Për pyetjen 9 të pyetësorit standard, ka paraqitur informacion për sa i është kërkuar, për shpenzime të kryera prej vetë atij. Diferenca prej 46.638,32 USD është paguar nga i vëllai e nuk mund të përfshihej në përgjigjen e tij. Po kështu, për pyetjen 5/b të pyetësorit nr. 2, u ka qëndruar rigoroz pyetjeve duke deklaruar saktë sa i është kërkuar.

19.4. Në analizë të pretendimeve të Komisionerit, akteve të administruara dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, siç do të shtjellohet gjerësisht më poshtë, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin që vlerësimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri, nuk mbështetet në një vlerësim të drejtë të fakteve që kanë rezultuar nga hetimi administrativ dhe gjyqësor i kryer në Kolegj për vlerësimin e pasurisë, si dhe në legjislacionin e zbatueshëm. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një shumë kredie konsiderueshëm më të lartë sesa ishte në të vërtetë, deri në tetor 2021, ai gjendet qartë në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë dhe pagesës së pretenduar si kësti i dytë i shlyerjes së kësaj pasurie. Shpjegimet e subjektit mbi arsyet për të cilat ka deklaruar vlerën prej 261.000 USD, dhe jo 217.500 USD, që është aprovuar realisht nga banka kredidhënëse [215.528,37 USD lëvruar realisht], duke e shtuar vlerën e burimit që ka përbërë kredia me **45.471,63 USD**, ose rreth 20% më tepër, përveçse të pakuptimta, janë edhe jobindëse. Fakti që për herë të parë, vlera e saktë e kredisë/burim krijimi pasurie është dokumentuar vetëm në *tetor 2021*, me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, përbën në vetvete një përpjekje të subjektit për të pamundësuar kontrollin tërësor të pasurisë së deklaruar që diktohet nga dispozitat që rregullojnë procesin e rivlerësimit. Në kushtet kur deklarimi i një vlere të ndryshme ka pasoja të drejtpërdrejta në analizën financiare të burimeve dhe detyrimeve, shpjegimet e dhëna nga subjekti, paraqiten joshteruese dhe të diktura nga nevoja për të përmirësuar situatën e deklaramimeve të mangëta prej tij.

19.5. Konkluzioni i sipërcituar i trupit gjykues të Kolegjit, mban në konsideratë sa rezulton nga dokumentacioni mbështetës i referuar në vijim.

a. Në kontratën e shitjes së datës 17.02.2012, çmimi i rënë dakord nga palët është 290.000 USD. Një pagesë prej 29.000 USD do të kryhet me nënshkrimin e kontratës, në adresë të avokatit të palës shitëse [të përcaktuar në kontratë]. Bilanci përfundimtar, prej 261.000 USD, do të paguhet në një nga format e pagesës së parashikuar në kontratë – në *cash* për vlera të kufizuara dhe me çek bankar të vërtetuar – për fondet e pranueshme³⁴. Në kontratë, përcaktohet edhe që detyrimi i blerësit kushtëzohet nga lëshimi brenda një kohe të caktuar nga marrja e kopjes së kontratës [nga blerësi apo avokati], i një angazhimi me shkrim nga një huadhënës institucional, që pranon t’i japë blerësit një kredi të parë hipotekore në kushte të pranueshme për blerësin. Gjithashtu, njoftimet që secila palë mund të dëshirojë/kërkojë t’i japë palës tjetër, do të konsiderohen nëse dërgohen me postë të regjistruar ose të vërtetuar, në adresë të avokatëve të palëve [të përcaktuar në kontratë].

b. W. F. Bank ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për miratimin e aplikimit për kredi sipas kushteve dhe afateve të përshkruara³⁵, në shumën prej **217.500 USD**, dhe normë interesi 4,25%. Angazhimi nga banka mund t’i nënshtrohet një konsiderimi të dytë, në rast ndryshimi të kushteve³⁶.

c. Në “Deklarimin e kushteve dhe termave të huadhënies” [Truth in-Lending Disclosure], me datë 17.02.2012, dërguar subjektit nga W. F. Bank, vlera e shumës së financuar pasqyrohet në 215.504,03 USD. Në shkresë citohet edhe përqindja vjetore, mënyra e pagesës; në fund specifikohet që ky dokument duhet të përdoret *vetëm nga avokatët e marrësit*³⁷.

ç. Në “Deklarimin e kushteve dhe termave të Huadhënies”, datë 21.05.2012, pasqyrohet që vlera e kredituar është **215.528,37 USD**, sikurse edhe kushtet e kostot e tjera, si: përqindja vjetore e mënyra e pagesës.

d. Në “Raportin mbi transferimin e pasurisë së paluajtshme” [Real Property Transfer Report], datë 02.05.2012, përcaktohen data e kontratës, 17.2.2012, data e transferimit të pronës, 21.05.2012 dhe çmimi i shitjes, 290.000 USD.

19.6. Në DPFDF-në në vitin 2014, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri me çmimin e blerjes 290.000 USD dhe burim krijimi: *kësti fillestar prej 29.000 USD [paguar] dhe kredi nga W. F. Bank*, në vlerën **261.000 USD**. Në këtë deklaratë, në rubrikën që u dedikohet detyrimeve, subjekti ka

³⁴ Paragrafi 7 parashikon: “Fondet e pagueshme sipas kësaj kontrate, përveçse kur specifikohet ndryshe, do të paguhet me: a) para në dorë, por jo më shumë se 1.000,00 USD; b) çek i certifikuar nga blerësi ose çek zyrtar i lëshuar nga çdo bankë, bankë kursimi, shoqëri besimi ose shoqëri kursim-krediti që ka një zyrë bankare në shtetin e Nju Jorkut, i pamiratur dhe i pagueshëm me porosinë e shitësit, ose shitësi mund t’i drejtojë blerësit një njoftim paraprak të arsyeshëm (me telefon ose ndryshe); c) për sa u përket parave të ndryshme nga çmimi i blerjes që i paguhet shitësit në mbyllje, çek i pacertifikuar i blerësit deri në shumën 500.00 USD; d) siç është rënë dakord me shkrim nga shitësi ose avokati i shitësit”.

³⁵ Conventional Commitment Letter (Notice of Terms), ose letër e zakonshme angazhimi e njoftim i kushteve.

³⁶ Paraqitur nga subjekti me vulë apostile gjatë hetimit administrativ, administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 07.12.2021.

³⁷ Ky dokument është paraqitur prej subjektit bashkëlidhur deklaratës “vetting”, si dhe me vulë apostile gjatë hetimit administrativ në Komision.

pasqyruar: [...] *kredi për blerje shtëpie banimi në W. F. Bank, më 21.5.2012, në shumën 261.000 USD [...], dhe detaje që lidhen me termat e shlyerjes së detyrimit. Në kolonën e detyrimit financiar të mbetur pa shlyer, subjekti ka specifikuar shumën 217.500 USD, si: [...] Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer deri në datën e fillimit të punës.*

19.7. Në deklaratat periodike të pasurive dhe interesave të dorëzuara në ILDKPKI, për vitet 2014-2016 (në vijim “DIPP”), qasja e subjektit ka qenë kontradiktore. Konkretisht, ndërsa në rubrikën përkatëse të formularit të deklarimit të detyrimeve sipas ligjit nr. 9049/2003, në faqen 5, subjekti ka deklaruar një hua dhe një kredi tjetër, për vitin 2015, ka deklaruar shumën e mbetur pa shlyer të kredisë së bashku me pasuritë. Për vitin 2016, subjekti ka deklaruar në rubrikën përkatëse shumën e mbetur pa shlyer. Në asnjë nga këto deklarata periodike vjetore, subjekti nuk ka deklaruar kredinë e marrë në vlerën totale.

19.8. Në deklaratën *vetting*, njësoj si në DPF, subjekti ka deklaruar për bashkëpronësinë dhe çmimin e blerjes [290.000 USD]. Për sa u përket burimeve të krijimit të pasurisë, subjekti ka deklaruar: *kursime të akumuluar para emërimit si gjyqtar, datë 10.7.2014, dhe kredi nga W. F. Bank.* Vlerat respektive të secilit burim nuk janë deklaruar. Në rubrikën e dedikuar detyrimeve, subjekti ka pasqyruar: *kredi ndaj W. F. Bank, deri më datë 01/12/2016, detaje të tjera të fillimit, kështu dhe interesit, dhe ka specifikuar se shuma e pashlyer në datën e fillimit të rivlerësimit [28.01.2017], ishte në vlerën 184.646 USD.*

19.9. Në fillim të hetimit administrativ, në përgjigje të tri pyetjeve të ndryshme në pyetësin *standard*, subjekti ka deklaruar se W. F. Bank e ka financuar këtë pasuri në shumën prej **261.000 USD**. Konkretisht, subjekti është shprehur që: *[...] kredia në vitin 2012 është financuar në shumën prej 261.000 USD nga W. F. Bank” [...] Kësti i parë [...] 29.000 USD [...] Ndërsa diferenca prej 261.000 USD, kredituar nga W. F. Bank, si dhe: [...] financim në shumën prej 261.000 USD nga W. F. Bank për [...] shtëpi banimi [...], respektivisht në përgjigje të pyetjeve nr. 4, nr. 9 dhe nr. 19.* Pasi Komisioni i drejtoi pyetje specifike dhe kërkoi dokumentacion justifikues, në pyetësin nr. 2, subjekti ka shpjeguar që diferenca e çmimit në vlerën 261.000 USD, pasi është paguar kësti i parë prej 29.000 USD, do të paguhej në vijimësi.

19.10. Në listën e dokumentacionit justifikues, referuar pjesërisht në gjuhën angleze, subjekti ka pasqyruar dy fakte kundërthënëse. Konkretisht, ndërsa në njërin paragraf ka shpjeguar se “shuma e akorduar e kredisë, është 217.500 USD”, një paragraf më poshtë, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për vërtetim nga banka për pagesat e kryera për shlyerjen e kredisë për çdo vit kalendarik, subjekti ka elaboruar në shqip se: *diferenca e çmimit (pas pagesës së kështit të parë) “është kredituar nga W. F. Bank³⁸”.* Me fjalë të tjera, në këtë shpjegim, subjekti sërish deklaroi se

³⁸ *Faqe 7 e pyetësin nr. 2, përgjigjet e pyetjes 5, germa “c”, ku subjekti shprehet tekstualisht: “Diferenca e çmimit (pas pagesës së kështit të parë/down payment), është kredituar nga W. F. Bank. Afati i maturimit të kredisë është data 21.05.2032, me interes fiks 4,250% në vit. Pagesa për shlyerjen e kësaj kredie ka filluar në datën 21.05.2012 [...]”.*

vlera 261.000 USD që përftohet nga diferenca mes çmimit 290.000 USD dhe këstit të parë, prej 29.000 USD, është kredituar nga banka.

19.11. Përmes pyetësorit nr. 3³⁹, Komisioni ka kërkuar sërish një kopje të plotë të kontratës së shitblerjes, pasi ka konstatuar se subjekti ka përcjellë *vetëm* faqen e parë të saj. Po ashtu, Komisioni ka kërkuar shpjegime për dokumentin “Letër standarde angazhimi”, si dhe ka kërkuar dokumente që provojnë shumën e aprovuar dhe të disbursuar të kredisë, kohën e disbursimit në llogarinë e shitësit, kontratën e plotë të kredisë, si dhe çdo dokumentacion që hedh dritë mbi paqartësitë e evidentuara. Vetëm në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti ka paraqitur të plota⁴⁰ kontratën e shitjes së pasurisë dhe kontratën e kredisë.

19.12. Në shpjegimet e dhëna, subjekti ka pretenduar se dokumentet e sjella prej tij më parë në mënyrë të pjesshme, ishin të mjaftueshme meqenëse “përmbanin elementet thelbësore të kontratave” e se flitet për *kontrata tip*. Më tej, subjekti ka specifikuar se shuma e kredituar nga W. F. Bank është 217.500 USD, sikurse edhe shpjegime të tjera irrelevantë. Së fundmi, subjekti ka shpjeguar se shuma u pagua nga ai [subjekti] dhe vëllai bashkërisht, por transaksioni është kryer nga i vëllai [z. K. G.], i cili ka paguar edhe një shumë prej 46.638,43 USD për llogari të një personi tjetër juridik, “{***}”. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky i fundit ishte banka kredituese e shitësit të pronës. Të dyja shumat, 29.000 USD dhe 46.638,43 USD, përbëjnë kursimet e përbashkëta të tij dhe vëllait.

19.13. Në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, meqenëse Komisioni ka konstatuar ndër të tjera, deklaram të pasaktë të shumës së kredisë së financuar, përmbledhur më sipër në paragrafin 19.1, subjekti ka prapësuar si vijon.

a. Në DPDFD 2014 ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë sipas kontratës së shitjes së pasurisë, në mungesë të eksperiencës, meqenëse ky ishte deklarimi i tij i parë. Ndonëse ka qenë i paqartë nëse duhet të deklaronte bazuar në kontratën e shitjes apo shumat e paguara, ka zgjedhur të deklarojë burimin e krijimit të pasurisë sipas kontratës së shitjes. Sipas subjektit, në këtë deklaratë ka specifikuar detyrimet financiare *në rubrikën përkatëse, në vlerën 217.500 USD, e cila përkon me shumën fillestare të kredisë së marrë*. Kjo mënyrë deklarimi ka pasqyruar interpretimin e tij të kohës, qasje të cilën e ka ndryshuar në deklaramet e mëvonshme të pasurisë, duke deklaruar shumën e paguar dhe atë të mbetur pa shlyer, si edhe të dhënat për këstin mujor dhe kohëzgjatjen e kredisë. Në deklaratën *vetting*, ka ndjekur të njëjtën logjikë si në DPDFD, duke iu referuar kushteve thelbësore të kontratës së shitjes së pasurisë, për mënyrën e pagesës së çmimit prej 290.000 USD, ndarë në dy transhe, prej 29.000 USD si kapar dhe shumës prej 261.000 USD, *nëpërmjet një kredie bankare*.

³⁹ Përcjellë subjektit më datë 18.10.2021, duke evidentuar: “[...] Ju kujtojmë se për një pjesë të pyetjeve, kemi kërkuar informacion në pyetësorin e mëparshëm dhe informacioni i paraqitur nga ju ka qenë i paplotë”.

⁴⁰ Respektivisht, *kontrata e shitblerjes mes palëve, prej 11 fletësh, dhe kontrata e kredisë me bankën [Conventional Commitment Letter (Notice of Terms)] prej 5 faqesh*.

b. Pasaktësitë kanë qenë të paqëllimshme. Kontrata e kredisë, shuma e disbursuar dhe deklaruar në DPFĐ të vitit 2014, si dhe veprimi me çek bankar për pagesën e shumës 46.638,43 USD janë veprime të kryera dhe të pandryshueshme. Bashkëlidhur deklaratës *vetting* dhe DPFĐ 2014, ka dorëzuar dokumentin e aprovimit të kredisë dhe shumës së financuar në vlerën 217.500 USD.

19.14. Nga analiza e dokumentacionit të sipërcituar dhe e pretendimeve të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se rezultojnë të pakontestueshme disa fakte. Së pari, kredia e lëvruar nga W. F. Bank subjektit [dhe vëllait të tij] për blerjen e kësaj pasurie, ishte në vlerën **215.528,37** USD. Së dyti, subjekti nuk e ka deklaruar vlerën e saktë të kredisë që ka shërbyer për krijimin e pasurisë asnjëherë dhe në asnjë formë në DPFĐ dhe as në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin. Për herë të parë dhe kalimthi e më kundërthënie, subjekti ka dhënë vlerën e përafërt në pyetësorin nr. 2, duke e shtuar sërish vlerën në 261.000 USD një shpjegim më tutje. Për herë të parë, subjekti ka dhënë vlerën e saktë të kredisë dhe paraqitur dokumentacionin justifikues të saj vetëm në tetor 2021, me pyetësorin nr. 3, pasi është përballur me pyetjen direkte të Komisionit. Shpjegimet e gjata të subjektit, që anashkalojnë përgjigjet direkte e paraqesin justifikime, janë jobindëse e alogjike. Në këtë konkluzion, trupi gjykues ka parasysh, ndër të tjera, shpjegimet që ia atribuojnë mungesat e të dhënave mënyrës së kuptimit të formularit prej tij, sikurse edhe ato që argumentojnë se faqja e parë e kontratës është e mjaftueshme, apo që tentojnë të argumentojnë se vlera e kredisë dhe detyrimi i mbetur i pashlyer i saj, dy vite e gjysmë [në gusht 2014], pasi subjekti ka paguar 30 këste mujore prej përrreth 1.300 USD secili, argumenteve se ndonëse formulari i deklarimit shprehimisht referon detyrimin për deklarimin e vlerës së saktë të kredisë, ai ishte i dyzuar nëse duhet të deklaronte pagesat apo që ka pasur qasje të njëjtë në interpretimin e ligjit ndër vite.

19.15. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se fakti që subjekti ka përmbushur më së fundi këtë detyrim ligjor vetëm si pasojë e pyetjeve dhe kërkesave të përsëritura të Komisionit, dëshmon se qasja e tij evazive dhe shpjegimet e tejzgjatura e me fakte jorelevante bëhet në funksion të krijimit të përshtypjes se pasuria është financuar nga kredia për një vlerë prej 43.500 USD me tepër, ose rreth 20% më shumë sesa ka qenë kredia në realitet. Në kushtet kur vlera e kredisë ndikon në përpjesëtim të zhdrejtë me sasinë e burimeve të tjera financiare që kanë lejuar krijimin e pasurisë, dhe që subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë ekzaktësisht shifrën e saktë të burimeve financiare që kanë krijuar pasurinë, trupi gjykues vëren se mënyra e deklarimit të zgjedhur nga subjekti, përbën një përpjekje për të krijuar konfuzion dhe pamundësuar përlllogaritjen e saktë të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme që kanë gjeneruar pasurinë.

19.16. Përpos këtij fakti, deklarimi prej subjektit i një shpenzimi të kryer nga vëllai në një vlerë që nuk korrespondon me balancën e mbetur të çmimit [45.471,63 USD përkundër 43.500 USD], edhe duke abstraguuar nga fakti që pagesa i është kredituar një kompanie që nga burimet e hapura rezulton, që ndryshe nga sa pretendon subjekti, të mos jetë institucion financiar, por aktivitet i

dedikuar për kryerjen e punimeve dhe përmirësimeve në ambientet e brendshme⁴¹, vetëm pasi u bë e qartë për të nga përgjigjet e pyetësorit nr. 3, diferenca e dukshme dhe e konsiderueshme mes kredisë së marrë dhe asaj të deklaruar, u vlerësua nga trupi gjykues si tregues i pasaktësisë dhe mungesës së sinqeritetit të subjektit, në kundërshtim me detyrimet që ai ka marrë përsipër duke iu nënshtruar procesit të rivlerësimit.

19.17. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se pretendimi i subjektit se nga deklarimi i detyrimit ndaj W. F. Bank, evidentohet diferenca e paguar prej 43.500 USD, së cilës “duke i shtuar komisione disbursimi/administrimi për kredinë, gjenerohet pagesa prej 46.638,43 USD”, e kryer nga i vëllai, është i pabazuar. Ky pretendim në vetvete përbën ilustrim domethënës të mënyrës jotransparente të zgjedhur nga subjekti për deklarimin e pasurisë dhe detyrimeve, në kushtet kur kërkohet nga institucionet e rivlerësimit të identifikojnë një shumë që përftohet duke kryer veprime matematikore, në mungesë dokumentacioni. Në kushtet kur barrën e provës për të deklaruar saktë shpenzimet dhe justifikuar me dokumentacion mbështetës, e ka subjekti, ky pretendim rezulton absurd.

19.18. Neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016 parashikojnë detyrimin e subjekteve për të dorëzuar *një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë*, dhe udhëzime të detajuara të mënyrës së deklarimit, sikurse edhe penalitete në drejtim të prezumimit të masës disiplinore të shkarkimit, nëse vërtetohet deklarim i pasaktë e i pamjaftueshëm. Më tej, udhëzimi i Inspektorit të Përgjithshëm të IDKPKI-së⁴², përcakton llojin e dokumentacionit mbështetës për të përmbushur detyrimet që përcakton Kushtetuta dhe ligji⁴³. Nga leximi harmonik i këtyre dispozitave, rezultojnë udhëzime shteruese të objektit të deklarimit, *burimeve të krijimit të tyre dhe detyrimeve financiare* ndaj personave fizikë e juridikë, në vlerën e mbetur pa shlyer dhe në total, sikurse edhe *shumën e shpenzimeve të kryera*⁴⁴.

⁴¹ Sipas burimeve të hapura, kompania në fjalë, krijuar që në vitin 1998, ka për objekt veprimtarie ndërtime e rimodelime të ambienteve të brendshme dhe ndërtim mobiliesh me porosi, sikurse edhe ndërtime rrugësh. Shih, ndër të tjerë, <https://www.facebook.com/profile.php?id=100063835403346&fref=ts>, ose:

<https://www.bbb.org/us/ny/jamaica/profile/home-improvement/barry-fishelberg-co-inc-0121-22209>,

<https://www.angi.com/companylist/us/ny/jamaica/barry-fishelberg-co-revieës-2319798.htm>.

⁴² Udhëzim nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 10 tetor 2016.

⁴³ Në pikën 7, udhëzimi përcakton: “Për çdo pasuri [...] subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojnë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre [...]”; dhe në nenin 25 të udhëzimit përcaktohet se: “Nëse subjekti i rivlerësimit dhe/ose personat e lidhur me të, kanë pasuri jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të paraqesin deklaratimet bankare të viteve të fundit, të dhënat e fundit mbi regjistrimin e pasurisë, si dhe dokumente të tjera që tregojnë vlerën e pasurive që ndodhen jashtë vendit”.

⁴⁴ Formulari për deklarimin e pasurive përcakton si vijon: “**Objekti i deklarimit:** Të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, [...] burimet e krijimit të tyre [...], të ndodhura brenda dhe jashtë vendit [...]”.

Në vijim, **përshkruani hollësisht:** llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumën e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni, dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie”. Në rubrikën “**Detyrimet**

19.19. Në kushtet kur të dhënat e plota e të sakta për secilin prej burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë, nuk janë deklaruar as në deklaratat periodike të dorëzuara, për vitet kur ka të tilla, ushtrimi i kontrollit të ligjshmërisë së tyre, sipas parimeve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji, pamundësohet. Po ashtu, nga krahasimi i përmbajtjes së deklaratave, rezulton që në ndryshim nga deklarata e pasurisë përpara fillimit të detyrës, në deklaratën *vetting* subjekti nuk ka deklaruar jo vetëm vlerën specifike të burimeve të krijimit të pasurisë, apo totalin e kredisë, por as edhe detyrimin e mbetur ndaj W. F. Bank. Këto mospërputhje dëshmojnë të kundërtën e pretendimit të tij për ndjekje të së njëjtës qasje, diktuar nga një interpretim i tij për mënyrën e deklarimit. Sqarimet në ndihmë të subjekteve deklaruese në formular, nuk krijojnë premisa për keqkuptime lidhur me çfarë kërkohet/duhet të deklarohet⁴⁵, një argument veçanërisht i pakuptimtë nga një magjistrat, detyrë e të cilit është interpretimi e zbatimi i ligjit.

19.20. Së pari, siç është shtjelluar gjerësisht më sipër, për herë të parë, kjo pagesë është deklaruar nga subjekti vetëm në përgjigje të pyetësorit 3. Në deklaratat e kryera në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, si dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, nuk ka asnjë gjurmë të kësaj pagese. Gjatë hetimit administrativ, pasi për herë të parë ka saktësuar vlerën e kredisë reale të përfituar dhe ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues, subjekti ka paraqitur një kopje të këtij çeku, si pjesë e pagesës së kështit të dytë dhe që ezauronte detyrimet e blerësve ndaj shitësve, së bashku me kredinë e lëvruar nga W. F., në vlerën 215.528,37 USD. Çeku i mësipërm është i vetmi dokument i sjellë nga subjekti, krahas atij që dokumenton pagesën e kështit të parapagimit prej 29.000 USD, për të provuar kalimin e pronësisë. Sipas subjektit, përfituesi i shumës, “{***}” {***}, ishte “institucioni kreditor i shitësve”. Subjekti ka shpjeguar se çeku bankar për kryerjen e pagesës prej 46.638,43 USD ka të njëjtën datë me finalizimin dhe disbursimin e kredisë, se me lëshimin e tij, është plotësuar kushti i fundit i vendosur nga banka, e cila ka pranuar disbursimin, dhe që në datën 21.05.2012, është përmbyllur procesi i blerjes së pasurisë⁴⁶.

19.21. Së dyti, përpos faktit të mosdeklarimit të modaliteteve të pagesës nga subjekti deri në tetor 2021, trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe vlera e pasqyruar në çek, nuk përkon aritmetikisht me balancën e mbetur për t’u paguar nga blerësit pas zbritjes së kështit të parë dhe transferimit të kredisë

financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, udhëzohet deklarimi i detyrimeve financiare, si: “[...] (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e deklarimit të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. [...] Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin) dhe kështin mujor. Përshkrimi i detyrimeve: Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të rivlerësimit”.

⁴⁵ Në krye të formularit, në ndihmë të subjekteve deklaruese, sqarohet: “[...] Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti), dhe kështin mujor. Nën këtë sqarim, vetë formati i formularit, i ndarë në dy kolona të titulluara “Përshkrimi i detyrimeve” dhe “Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer deri në ditën e fillimit të punës”, nuk krijon asnjë premisë për deklarimin e shumës së aprovuar të kredisë, si detyrim i mbetur pa shlyer.

⁴⁶ Shih prapësimet e subjektit për rezultatet e hetimit administrativ, pika 67.

së përfituar. Kjo shumë është aritmetikisht më e lartë sesa shifra prej 45.471,63 USD⁴⁷, që është balanca e mbetur pa paguar.

19.22. Së treti, ndërsa rezulton që subjekti ka fituar pronësinë⁴⁸ në të njëjtën datë me atë që mban çeku bankar [me shumën 46.638,43 USD], ky i fundit nuk përbën provë bindëse që pagesa e kryer, ka përbërë në fakt këstin e dytë. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që flitet për (i) një vlerë të ndryshme nga balanca e mbetur, (ii) paguar një personi juridik që nuk rezulton të jetë institucion financiar – shih më sipër për objektin e veprimtarisë së këtij personi juridik sipas burimeve të hapura – (iii) dhe nuk referon asgjë që ta lidhë me shitësit apo me zyrën e tyre avokatore, cituar në kontratën e datës 17 shkurt 2012, në ndryshim nga pagesa e këstit të parë prej 29.000 USD, paguar në adresë të “{***}” {***} dhe referuar si “avokatë”⁴⁹.

19.23. Po ashtu, shpjegimi i subjektit se vlera e paguar me çek është e ndryshme nga balanca e mbetur pasi përfshin shpenzime të tjera administrative [komisione disbursimi/administrimi të kredisë], edhe duke pranuar të mirëqenë pretendimin e subjektit për natyrën e aktivitetit të përfituesit të shumës në fjalë, mbetet alogjik. Në kushtet kur subjekti kishte marrë kredinë nga W. F. dhe ishte debitor i asaj banke, duket e pakuptimtë që një institucion tjetër financiar, për më tepër një “kreditues i shitësit”, të faturonte subjektin për kredinë e marrë gjatë.

19.24. Së fundmi, edhe shpjegimet e subjektit për mosdeklarimin e shumës 46.638,43 USD asnjëherë deri në pyetësin nr. 3, janë inkohente dhe alogjike, nën dritën e sa është shtjelluar më sipër për detyrimet e qarta që rezultojnë nga ligji nr. 9049/2003 e ligji nr. 84/2016 dhe formularët në zbatim të tyre. Subjekti jep shpjegime [të tejzgjatura] përse në DPFD-në 2014 ka deklaruar detyrimet e likuiduara nga ai vetë – prej 29.000 USD dhe jo detyrimet e shlyera prej vëllait – apo që ka pasqyruar në mënyrë “fotografike” detyrimet në momentin e krijimit të kësaj pasurie (21.05.2012), dhe jo ato që kishte në momentin e deklarimit (10.07.2014). Të gjitha këto shpjegime janë jobindëse e paraqiten si përpjekje për të justifikuar mosdeklarimet e kryera prej tij ndër vite apo në funksion të rivlerësimit. Në kushtet kur gjatë hetimit administrativ, sikundër evidentohet e pasqyruar edhe në vendimin e Komisionit, subjekti ka shpjeguar se pagesa e këstit të parë/downpayment prej 29.000 USD, si dhe ajo e këstit të dytë prej 46.638,43 USD, janë bërë nga kursimet e përbashkëta të tij dhe vëllait⁵⁰, dhe që pagimi i kësaj shume ishte kusht për finalizimin e kontratës së shitblerjes, pasqyrimi në mënyrë “fotografike” i momentit të krijimit të kësaj pasurie – *logjikshëm do të pritej të jepte shkas për subjektin që të deklaronte një shumë të tillë të konsiderueshme [46.638,43 USD], që përbën 16% të vlerës së pasurisë, e që së bashku me*

⁴⁷ Konkretisht, duke zbritur nga vlera e shitjes së pasurisë, prej 290.000 USD, këstin e parë prej 29.000 USD dhe kredinë e disbursuar prej 215.528,37 USD, rezultati i balancës së mbetur do të ishte 45.471,63 USD.

⁴⁸ Sipas “Raportit të transferimit të pronësisë” [Real Property Transfer Report {***}], të nënshkruar prej palëve, mban datën 21.5.2012.

⁴⁹ Zyra avokatore e shitësve, cituar në kontratat mes palëve dhe parashikuar si mënyrë pagese në kushtet e kontratës. Shih paragrafin 19.5/a dhe poshtëshënimin korrespondues më sipër.

⁵⁰ Shih përgjigjen e pyetjes 4 në pyetësin 3, si dhe procesverbalin e seancës dëgjimore, administruar në dosjet e Komisionit, fashikulli 29, f. 119.

këstin e parë, përbënin 75.638,43 USD ose 26% të vlerës së pronës, paguar brenda një harku kohor tremujor, shkurt-maj 2012.

19.25. Duke shtuar në këtë kontekst edhe kundërthëniet e subjektit në faza të ndryshme të hetimit administrativ, shtjelluar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin që ky shkak ankimi i Komisionerit, është i bazuar. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit rezultojnë të pabazuara, sikurse edhe arsyetimi i Komisionit⁵¹.

19.26. Në përmbledhje të sa është argumentuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar shkakun e ankimit të Komisionerit. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting* si për sa i përket shumës së kredisë së përfituar për krijimin e kësaj pasurie, ashtu edhe për sa i përket pagesës së pretenduar si kësti i dytë i shlyerjes së kësaj pasurie. Nga aktet në fashikull, rezulton që detyrimin kushtetues e ligjor për deklaram të plotë e të saktë të kredisë dhe pagesave të kryera, subjekti i rivlerësimit e ka përmbushur për herë të parë vetëm në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të drejtuar atij nga Komisioni, me një pyetje shumë specifike për vlerën e saktë të kredisë së përfituar. Po ashtu, vetëm në pyetësorin nr. 3, subjekti i rivlerësimit përmbushi për herë të parë edhe detyrimin për dorëzimin e kontratës së plotë të shitjes së kësaj pasurie, ku saktësoheshin vlerat financiare që shoqërojnë transaksionin e blerjes së kësaj pasurie, sikurse edhe pagesën e një vlere prej 46.638,43 USD, të kryer më datë 21.05.2012.

19.27. Shpjegimet e subjektit për arsyet për të cilat nuk ka dhënë shpjegime të plota, të sakta dhe shteruese mbështetur në dokumentacion, rezultuan jobindëse dhe u panë nga trupi gjykues i Kolegjit si një përpjekje për të pamundësuar kontrollin e plotë të pasurisë, të cilit ai i nënshtrohej në kuadër të procesit të rivlerësimit, për shkak të detyrës si gjyqtar. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimet që burojnë nga neni D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

- 20.** Një tjetër shkak ankimi i Komisionerit Publik, bazuar në rekomandimin e ONM-së, është ai që lidhet me pamjaftueshmërinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të kryer pagesat e dy kësteve të mësipërme, që kanë shërbyer për të krijuar pasurinë në fjalë. Pjesë e këtij shkak ankimi, është edhe analiza e zgjeruar më sipër e Kolegjit për pretendimin e subjektit të rivlerësimit për pamundësi objektive për të siguruar dokumentacion justifikues për të ardhurat që i përkasin punësisimit të tij në ShBA, në harkun kohor gusht 2003 - dhjetor 2004. Meqenëse trupi gjykues i Kolegjit e ka arsyetuar këtë shkak në mënyrë shteruese dhe ka konstatuar se vendimi i Komisionit është i pabazuar, në këtë rubrikë, arsyetimi do të ndalet vetëm në analizën që i përket mjaftueshmërisë së burimeve financiare për të krijuar dy këstet e pasurisë. Konkretisht, Komisioneri Publik argumenton se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve për pagesën e këtyre dy kësteve, parashikuar në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, për

⁵¹ Shih vendimin e Komisionit, ndër të tjera, në paragrafin e parë, f. 46.

një balancë negative prej përreth (-) 16.000 USD deri në datën e kryerjes së pagesës së kështit të dytë [21.05.2012].

20.1. Komisioni ka konstatuar fillimisht një balancë negative prej afërsisht (-) 131.000 USD të burimeve të ligjshme, për të paguar vlerën prej 75.638 USD për blerjen e pasurisë objekt analize dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës. Duke përjashtuar nga analiza financiare harkun kohor 2003-2005, me arsyetimin se subjekti “nuk ka deklaruar pasuri” të krijuar në këtë periudhë kohore dhe meqenëse subjekti ka dorëzuar dokumente shkresore për të ardhura vetëm pas vitit 2005, Komisioni ka bazuar vendimin në interpretimin e çfarë ka dashur të deklarojë subjekti, si burim krijimi pasurish⁵². Në vendimin përfundimtar, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për të kryer këtë pagesë, duke marrë në konsideratë gjithë pretendimet e kërkimit e subjektit për reduktim shpenzimesh, përfshirë edhe ato të deklaruara prej atij vetë, dhe shtim të ardhurash, përfshirë edhe të ardhura të padokumentuara, “me analogji” apo bazuar në “mundësinë për kursim” dhe në konsideratë të pretendimit të tij për “pamundësi objektive për të sjellë dokumentacion” – analizuar më sipër në këtë arsyetim.

20.2. Në parashtrimet e tij në Kolegj, përpos sa është shtjelluar gjerësisht në pjesën e arsyetimit të Kolegjit, në përgjigje të pretendimeve të subjektit për kushtet e pamundësisë objektive dhe për përfshirjen e harkut kohor gusht 2003 - dhjetor 2004 në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ai dhe familja kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme, kërkoi që të merreshin në konsideratë aktet e cituara më sipër për të provuar punësimin e tij edhe në këtë periudhë kohore, si dhe kontestoi edhe shpenzimet e jetesës, dhe përgjithësisht, totalin e vlerës së shpenzimeve, të cilat, në fakt rezultojnë se Komisioni i ka bazuar krejtësisht në vlerën e kërkuar prej tij. Me fjalë të tjera, ndonëse Komisioni i kishte përlllogaritur shpenzimet e jetesës së familjes [së zgjeruar] të subjektit, në vlerën e kërkuar prej tij, prej 217.900 USD, për periudhën kohore 2005-2012⁵³, në Kolegj, subjekti kërkoi të reduktoheshin këto shpenzime më tej. Konkretisht, subjekti kërkoi që nga shpenzimet jetike sipas standardit zyrtar të prodhuar nga institucione të asociuara me qeverinë federale për nivel varfërie, subjekti kërkoi që për të, të përdorej një nivel më i ulët, për të marrë në konsideratë shpenzimet për qira sipas vetëdeklarimit të tij të pranuar nga Komisioni.

20.3. Pasi analizoi në tërësi shkaqet e ankimit, aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nën dritën e ligjit të zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se vendimi i Komisionit është i pabazuar në ligj dhe i pambështetur në një analizë të drejtë. Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pamundësisë të pagesës së kësteve prej 75.638 USD me burime të ligjshme. Balanca negative financiare prej (-) 16.000 USD, e argumentuar nga Komisioneri

⁵² Paragrafi 49.1/v, faqe 30 dhe 31 e vendimit të Komisionit. Komisioni shprehet: “[...] fakti që subjekti nuk ka sjellë dokumentacion për të ardhurat përpara vitit 2005, përforcon bindjen se subjekti ka dashur të deklarojë burim krijimi të pasurive, të ardhurat nga viti 2005 e në vijim [...]”. Shih: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2022/05/Vendim-Kastriot-Gramshi.pdf>.

⁵³ Referuar prapësimeve të subjektit të rivlerësimit për rezultatet e hetimit administrativ. Në faqen 24 të prapësimeve, subjekti kërkon shprehimisht [gabimet drejtshkrimore janë të autorit]: “Bazuar sa më lartë, vlerësojë se në analizën financiare vlera e shpenzimeve jetike duhet të korrigojë në vlerën **217,900 USD**”.

Publik, konfirmohet. Në vijim, shtjellohet analiza mbi të cilën mbështet ky konkluzion i trupit gjykues të Kolegjit.

20.4. Në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin [deklarata *vetting*] dhe DPDFD [gusht 2014], subjekti ka deklaruar si burim krijimi të pasurive të ndodhura në ShBA, *kursime të akumuluar para emërimit si gjyqtar* në datën 10.07.2014. Me fjalë të tjera, nga shpjegimi i dhënë, rezulton një moment fundor krijimi. Nga ana tjetër, siç edhe është shtjelluar gjerësisht më sipër, subjekti ka kryer detyrën e gjyqtarit për thuajse pesë (5) vjet përpara se të ishte formalizuar dorëheqja. Në kontrollin e vendimit të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se të ardhurat përpara gushtit 2003, nuk duhet të përfshihen si burim krijimi i kësaj pasurie për disa arsye. Së pari, subjekti ka deklaruar që së bashku me familjarët ka transferuar nga Shqipëria në ShBA në *cash*, shumën prej 20.000 USD. Po ashtu, llogaria e tij bankare në Shqipëri, gjatë periudhës që ishte jashtë, nuk rezulton të jetë pakësuar. Së fundmi, nga aktet në fashikull⁵⁴, rezulton që subjekti ua ka atribuar këtyre të ardhurave krijimin e një pasurie në Tiranë, në vitin 2016.

20.5. Ndryshe nga sa konkludon Komisioni në vendim, subjekti *nuk* ka pretenduar se nuk ka krijuar pasuri gjatë periudhës 2005-2012. Përkundrazi, subjekti ka pretenduar në Komision krijimin e një pasurie në prill 2005 – automjet BMW – edhe me kursimet e vitit 2004⁵⁵, dhe që “gjatë kohës së qëndrimit në ShBA, me të ardhurat e krijuara në NY”, është krijuar pasuria objekt analize⁵⁶.

20.6. Në përmbledhje dhe pa përsëritur sa është konkluduar edhe më sipërnë këtë arsyetim, Kolegji ia nënshtroi kontrollit të tij vendimin e Komisionit, duke përfshirë edhe periudhën kohore 2003-2005 [ose dhjetor 2004], nën dritën e dispozitave që rregullojnë deklarinimin dhe kontrollin e pasurive në procesin e rivlerësimit, si dhe rrethanave konkrete të ilustruara më sipër e që lidhen me sa rezulton nga pohimet e subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurive dhe të ardhurat e krijuara. Në vijim të së njëjtës logjikë, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se pasuritë në ShBA nuk duhet t’i nënshtrohen kontrollit/verifikimit të thelluar, meqenëse janë krijuar gjatë një harku kohor kur ai nuk kryente detyrën e gjyqtarit, apo për shkak se legjislacioni i rivlerësimit nuk shtrihet mbi pasuritë jashtë Shqipërisë meqenëse i janë nënshtuar një ligji tjetër vendor [arsyetuar më sipër].

20.7. Pa përsëritur arsyetimin në paragrafin 17 dhe nënpjesët e tij, trupi gjykues ka artikuluar tashmë edhe jurisprudencë në vendime të ndryshme⁵⁷. Së dyti dhe siç arsyetohet më sipër, subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtarit për gati pesë (5) vite përpara largimit. Në momentin e hyrjes në fuqi

⁵⁴ *Prapësimet e subjektit të rivlerësimit për rezultatet e hetimit administrativ, faqe 6, paragrafi 3 e në vijim.*

⁵⁵ *Si më sipër, faqja 32, pika 103. Subjekti shprehet: “[...] Gjatë viteve 2003-2004, ne kemi qenë të gjithë në punë, [...] përveç nënës. Gjatë kësaj kohe, ne kemi realizuar të ardhura të mjaftueshme për të pasur mundësi për blerjen e automjetit në vlerën 13.000 USD”.*

⁵⁶ *Si më sipër, faqja 19.*

⁵⁷ *Shih vendimet e Kolegjit që lidhen me çështjet e subjekteve të rivlerësimit Artan Zeneli (JR,) nr. 2/2019, Artor Ylli(JR) nr. 31/2019, Pashk Gjaci (JR) nr. 12/2020, Ana Gollosi (JR) nr. 13/2020, Enkeledi Hajro (JR) nr. 3/2021, ndër të tjerë.*

të ligjit nr. 9049/2003⁵⁸, subjekti ushtronte detyrën e gjyqtarit. Subjekti nuk ka përmbushur detyrimin për deklaram para fillimit të punës në funksionin e gjyqtarit apo atë pas largimit nga funksioni, pavarësisht parashikimit ligjor për detyrim për deklaram për një periudhe prej katër vjetësh⁵⁹. Edhe për shkak të këtyre rrethanave, arsyetimi i Komisionit që referon për moskryerjen prej subjektit vetëm të deklarimit të parë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9049/2003⁶⁰, vlerësohet i pabazuar, sikundër vlerësohet e pabazuar kryerja e analizës financiare duke segmentuar periudhat kohore. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit për mospërfshirje të viteve 2003-2004 në analizën financiare, vlerësohet i pabazuar.

20.8. Për të provuar punësimin e tij për vitet 2003-2004, subjekti paraqiti në Kolegj aktet e përmbledhura në paragrafët 8.7. dhe 14.4⁶¹. Datat e vlefshmërisë e të lëshimit të këtyre dokumenteve, siç arsyetohet më sipër, nuk provojnë të ardhura për periudhën në fjalë apo ligjshmërinë e tyre. Përpos këtij fakti, marrëdhënia e pretenduar e punës pranë Zyrës Imobiliare AMJ Fortune Reality Corp për së paku një periudhë disamujore, paraqitet jobindëse në kushtet kur ky person juridik është licencuar për të ushtruar aktivitetin për herë të parë në 21 maj 2004⁶². Pretendimin tjetër të subjektit se vetëdeklarimi në formularin *U.S. Individual Income Tax Return [form 1040]*, kryer prej tij për vitin 2005, tregon se ka qenë në marrëdhënie pune nga fillimi i këtij viti, në vijimësi nga viti 2004, për sa në këtë formular referohen vetëm të dhëna për të ardhurat e vitit 2005, vlerësohet prej trupit gjykues i pabazuar lidhur me provueshmërinë për të ardhura të ligjshme për vitin 2004.

20.9. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se u gjetën jobindëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit për të reduktuar shpenzimet e jetesës duke reflektuar qiranë e deklaruar, duke zbutur kështu balancën negative financiare të pasqyruar në ankimin e Komisionerit Publik, paraqitur nga subjekti për herë të parë gjatë gjykimit të zhvilluar në Kolegj. Së pari, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje që shpenzimet e qirasë janë vendosur nga Komisioni ekzaktësisht sa ka pretenduar subjekti, pa u mbështetur në dokumentacion, qoftë për vlerën e qirasë, qoftë për mundësinë e akomodimit të një familjeje të përbërë nga më shumë se pesë të rritur [prindërit, bashkëshortja, fëmijët, vëllai dhe bashkëshortja e këtij të fundit] përpos fëmijëve, apo për të verifikuar kontributin e secilit prej anëtarëve të familjes dhe mundësinë proporcionale me të ardhurat e tyre në përballimin e shpenzimeve. Së dyti, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur prapësime për këto shpenzime që përfshinin edhe vlerën e qirasë për banesën, ndonëse në rezultatet e hetimit administrativ, balanca negative e konstatuar nga Komisioni për një periudhë më të

⁵⁸ Ligji nr. 9049/2003 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 31, datë 15/05/2003 dhe ka hyrë në fuqi më 30.05.2003.

⁵⁹ Ligji nr. 9049/2003, në nenin 8, “Deklarimi pas funksionit”, parashikonte: “Subjektet, për të cilat është parashikuar detyrimi për deklaram, detyrohen të deklarojnë dhe për një periudhe prej dy vjetësh pas largimit nga funksioni. Presidenti, Kryeministri, ministrat, deputetet, zëvendësministrat, sekretarët e përgjithshëm, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të të gjitha niveleve të gjyqësorit, prokurorët, drejtorët e përgjithshëm të institucioneve qendrore, do ta kenë këtë detyrim për një periudhe prej katër vjetësh pas largimit nga funksioni”.

⁶⁰ Shih vendimin e Komisionit, paragrafi 100.4.

⁶¹ Licencë e agentit imobilar, lëshuar nga Departamenti i Shtetit të New York-ut dhe fotokopje e kartës hyrëse/identifikuese, lëshuar nga Washington Inventory Service.

⁶² https://dos.ny.gov/system/files/documents/2023/01/real-estate-license-law_12.2022.pdf.

shkurtër kohore, 2005-2014, rezultonte në një vlerë të konsiderueshme negative, në (-) 156.153 USD. Një pjesë e kësaj balance negative përfaqësohej edhe nga shpenzimet e qirasë.

20.10. Në këto kushte, duke ndjekur të njëjtën metodologji të konsoliduar për shpenzimet e jetesës së subjekteve të rivlerësimit në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj, sipas së cilës standardi i shpenzimeve të përlllogaritura nga institucionet zyrtare përkatëse, pranohet si rregull në gjithë zërat e vet, dhe duke pasur në konsideratë natyrën tejet teknike të statistikave të përdorura si standard bazik mbi të cilin përlllogariten shpenzimet jetike, bazuar mbi parime dhe pyetësorë të formuluar dhe fokusuar në të paktën pesë grupe parametrash të caktuar, mbi bazën e të cilëve institucionet federale udhëheqin programet sociale e ekonomike⁶³, nga staf i specializuar. Së fundmi, në kushtet kur shpenzimet e jetesës janë bazuar në nivelin e varfërisë sipas këtij standardi zyrtar që mbledh të dhëna nga pesë pyetësorë⁶⁴, trupi gjykues i Kolegjit e konsideroi metodologjinë e përdorur nga Komisioni, bazuar në të dhënat zyrtare të përlllogaritura nga autoritetet e ShBA-së, të drejtë. Për të njëjtën arsye dhe duke mbajtur në konsideratë që kjo kërkesë e subjektit të rivlerësimit është parashtruar në një fazë të avancuar të procesit, dhe pasi atij i ishin pranuar të gjitha shpenzimet sipas deklarimeve, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se pretendimi i subjektit në Kolegj, është i pabazuar. Në përfundim, subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të paguar këstin e parë dhe të dytë për krijimin e pasurisë shtëpi banimi në {***} [New York] dhe nuk arriti të rrëzonte barrën e provës për të provuar të kundërtën e pretendimeve për balancë negative prej (-) 16.000 USD, parashtruar nga Komisioneri Publik.

2. Depozitat bankare në Chase Bank dhe TD Bank në New York, ShBA

- 21.** Komisioneri Publik vlerëson se për sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit të kursimeve deri në datën 10.07.2014, sikundër edhe për pasurinë shtëpi banimi në ShBA, duke kryer analizë financiare për harkun kohor nga shtatori 2003, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte në pamjaftueshmëri financiare, e akumuluar në vlerën rreth (-) 25.863 USD. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës. Referuar edhe rekomandimit të ONM-së, Komisioneri parashtron se përfshirja në analizë edhe e mundësisë së kursimeve të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003 - 10.7.2014, do të ndikonte duke e kthyer vitin 2015 në vit me balancë negative mes të ardhurave e shpenzimeve, duke rezultuar në (-) 21.140 USD. Në këtë vit, është shlyer pjesërisht kredia për shkollimin e bashkëshortes së subjektit.

21.1. Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për depozitën në Chase Bank, çelur në gusht të vitit 2004, dhe për depozitën në TD Bank, çelur në nëntor të vitit 2013. Në përfundim të kësaj analize, Komisioni ka konstatuar pamundësi financiare për kursime në vlerën (-) 156.153 USD, për periudhën kohore 2005 - korrik 2014 [kur subjekti është riemëruar në detyrën e gjyqtarit]. Me riçeljen e hetimit administrativ, pas rishikimit të analizës, me përfshirje të të ardhurave të babait të subjektit, të ardhurave nga pensioni i prindërve për 6 muaj, si dhe rishikim

⁶³ Shih, ndër të tjerë: <https://www.census.gov/topics/income-poverty/poverty/guidance.html>.

⁶⁴ CPS Historical Poverty Footnotes (census.gov).

të shpenzimeve të jetesës duke konsideruar përbërjen familjare për vitet 2013 dhe 2014, ka rezultuar balanca në vlerën 1.820 USD. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka pasur mundësi të krijojë depozitat me të ardhura të ligjshme të krijuara në ShBA.

21.2. Në parashtrimet e tij në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, përpos sa është përmbledhur e analizuar më sipër për çdo kërkesë respektive që lidhet me zëra të caktuar shpenzimesh dhe pamundësinë objektive për të siguruar dokumentacion për vitet 2003-2004, pretendoi po ashtu që depozita e parë, ajo në Chase Bank, është hapur në gusht 2004 për qëllime utilitare. Sipas tij, çelja e depozitës bankare nuk do të thotë balancë e caktuar likuiditetesh.

21.3. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi pretendimet e Komisionerit Publik dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit, nën dritën e ligjit të zbatueshëm dhe pas analizës së akteve në fshikull, arrin në konkluzionin që vendimi i Komisionit nuk është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar gjendjen e likuiditeteve në depozitat bankare dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera. Balanca negative e parashtruar nga Komisioneri u konfirmua edhe në analizën e kryer në Kolegj, në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit edhe për këtë aspekt të ankimit, rezultojnë kundërthënëse. Analiza e trupit gjykues detajohet në vijim.

21.4. Në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, subjekti ka deklaruar dy depozita bankare në ShBA, e konkretisht: (i) depozitë në Chase Bank, krijuar në gusht 2004, dhe gjendje më 31 dhjetor 2016 në vlerën 82.684,64 USD, me burim *të ardhurat nga pagat*; dhe (ii) depozitë në TD Bank, krijuar në nëntor 2013, gjendje në vlerën 263,51 USD më 31 dhjetor 2016, me burim *të ardhurat nga pagat*. Depozita e parë është deklaruar e gjitha në pronësi të subjektit, e dyta 50%. Në DPDFD, më 08.08.2014, subjekti ka deklaruar të njëjtat të dhëna, me përjashtim të gjendjeve që deri në 10.07.2014, janë deklaruar respektivisht 97.614,28 USD [Chase Bank] dhe 12.736,66 USD [TD Bank].

21.5. Pa ripërsëritur sa është arsyetuar gjerësisht më sipër për kohështrirjen e analizës financiare sipas vlerësimit të trupit gjykues të Kolegjit, sikurse edhe për argumentet që dëshmojnë përse subjekti nuk ka provuar pamundësinë objektive për të siguruar dokumentacion justifikues të të ardhurave, trupi gjykues vlerëson të ndalet në pretendimin e subjektit të rivlerësimit se çelja e llogarisë në Chase Bank, nuk është domosdoshmërisht tregues i një balance të caktuar financiare. Duke e pranuar në parim të mundshëm këtë skenar faktik, trupi gjykues i Kolegjit e gjen këtë pretendim të paarsyetuar dhe jobindës, pasi bie ndesh me gjithë analizën logjike të kryer, mbështetur edhe në pretendimet e subjektit në faza të ndryshme të procesit të rivlerësimit.

21.6. Konkretisht, në vijim të kundërthënive të sjella në vëmendje më sipër në këtë arsyetim, trupi gjykues i Kolegjit çmon të ilustron në detaj dhe literalisht kundërthëniet e subjektit të rivlerësimit për këtë aspekt. Në përgjigje të barrës së provës, për të provuar mundësinë e tij dhe të personave të lidhur për të krijuar kursime e pasuri ekzaktësisht në këtë periudhë kohore, 2003-2005, të cilën më pas Komisioni vendosi ta përjashtojë gjithsesi, për periudhën që përkon me çeljen

e llogarisë bankare në Chase Bank, subjekti ka prapësuar si vijon [me fokus të ardhurat për blerjen e automjetit në prill 2005]: [...] në analizën e vitit 2005, nuk janë përfshirë kursimet e familjes sime deri në fund të vitit 2004 [...] – pika 105, faqe 16; dhe: [...] Komisioni nuk duhet të konsiderojë burimin e krijimit të automjetit BMW vetëm me të ardhurat e vitit 2005 [...] – faqe 33, pikat 106 dhe 107; si dhe: [...] mundësia e kursimit për vitin 2004, është thujse njësoj sa viti 2005 [...] do të rezultojë se familja ime do të ketë mundësi kursimi në vitin 2004, një vlerë më të lartë se çmimi i automjetit [...] – faqe 33, pika 109; dhe, së fundmi: [...] rrogat e viteve 2004-2005, janë në të njëjtat nivele si mesatarja e viteve më pas [...] – faqe 32, pika 103.

21.7. Përkundër këtyre pretendimeve të cilat bëhen për të provuar mundësi të konsiderueshme disponimi të ardhurash dhe kursimesh qysh në vitin 2004, në Kolegj, subjekti solli një version tjetër faktesh. Konkretisht, përveçse kontestoi ekzistencën e ndonjë balance të depozituar në llogarinë bankare në Chase Bank, në parashtrime, subjekti pretendoi sa vijon: [...] përpara 2005 ka qenë periudhë stabilizimi, sigurohen nevojat bazike/mbijetesë pa pretendime për kursim [...], për të provuar përse nuk e ka parë të nevojshme të sillte dokumentacion të plotë për të justifikuar krijimin e pasurisë – faqe 14 e parashtrimeve; si dhe: [...] shkon përtej arsytimit logjik të pretendohet krijim pasurie prej tij në periudhën gusht 2003 - dhjetor 2004, me 20.000 \$ të transportuara dhe të ardhurat nga puna për periudhën korrik 2004 - dhjetor 2004 [...] – faqe 16 e parashtrimeve. Me fjalë të tjera, në Kolegj subjekti solli pretendime për të provuar jetesë në nivele mbijetesë, me të cilën nuk mund të krijohej pasuri dhe as kursime pasi flitet për “periudhë stabilizimi”.

21.8. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit kreu kontrollin e analizës financiare të Komisionit. Si rezultat i kësaj analize, duke ndjekur parimet e arsytuar më sipër për të pranuar të mirëqenë standardin e shpenzimeve jetike të referuar nga Komisioni, balanca negative e argumentuar nga Komisioneri Publik konfirmohet. Në kushtet kur në ankim nuk ka detajim të mënyrës se si janë përfutur balancat negative të parashtruara nga Komisioneri Publik, në Kolegj u përdor si bazë analiza me të cilën subjekti është njohur në rezultatet e hetimit dhe për të cilën ka pasur mundësi të mbrohet duke paraqitur argumentet e tij. Nga ana tjetër, ndonëse balanca negative kumulative që rezultoi në Kolegj për periudhën shtator 2003 – 2015, nuk është në vlerat e konstatuara nga Komisioni – (-) 156.153 USD – është sidoqoftë më e thellë sesa ajo e pretenduar nga Komisioneri. Konkretisht, balanca negative në Kolegj rezultoi (-) 37.800 USD, përkundër rreth (-) 25.863 USD. Në analizën e kryer në Kolegj, janë përfshirë vetëm shpenzimet e përlllogaritura nga Komisioni. Vlen të theksohet që në konsideratë të së drejtës të subjektit për proces të rregullt, edhe në Kolegj nuk u përfshinë për vitet 2007-2008, shpenzimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për shkollimin në Brooklyn College of the City of New York, për periudhën shkurt 2007 - qershor 2008⁶⁵, minimalisht në vlerën 11.000 USD [11 mijë USD/dy semestra]⁶⁶. Për arsye të paspecifikuara, këto shpenzime nuk janë përfshirë në analizë, nuk janë

⁶⁵ Shih raportin e KLD-së për vlerësimin profesional të subjektit, përcjellë Komisionit, faqe 3.

⁶⁶ <https://www.brooklyn.edu/bursar/tuition-and-fees/graduate/>

kërkuar shpjegime, si dhe as kanë gjetur arsytim për arsyet e përjashtimit në vendim nga Komisioni.

21.9. Në analizën e kryer në Kolegj, të ardhurat e subjektit dhe të prindërve janë përlllogaritur sipas dokumenteve në fashikujt e Komisionit. E njëjta qasje u zbatua edhe për të ardhurat nga qiraja për vitin 2015, kredinë për studime të bashkëshortes dhe huan nga motra e bashkëshortes, dhënë për shlyerje kredie. Shpenzimet e jetesës u përlllogaritën si në Komision, qoftë për qëndrimin në ShBA, ashtu edhe për atë në Shqipëri, duke filluar nga viti 2014. Shpenzimet e tjera⁶⁷ u llogaritën po ashtu sipas dokumentacionit në fashikujt e Komisionit.

21.10. Në përmbledhje, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e depozitave bankare në *Chase Bank dhe TD Bank*, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, sikurse edhe për të kryer shpenzimet e vitit 2015. Edhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës së dhënë nga Komisioni gjatë hetimit administrativ për këto pasuri dhe për sa parashtruar në ankimin e Komisionerit Publik. Për rrjedhojë, edhe për këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimet që burojnë nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, të parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

C. Pretendime të subjekti i rivlerësimit për aspekte të procesit të rregullt dhe interpretimit të ligjit

22. Në konkluzionet e tij përfundimtare, subjekti i rivlerësimit ngriti disa pretendime për proces të parregullt të zhvilluar për të, kryesisht nën dritën e garancive të nenit 6 të KEDNj-së dhe jurisprudencës së GjEDNj-së në interpretimin e kësaj dispozite. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se asnjëri prej këtyre pretendimeve nuk është i bazuar. Ky konkluzion bazohet në arsyetimin e detajuar në vijim, së bashku me një përmbledhje të argumenteve respektive të subjektit të rivlerësimit.

22.1. Subjekti pretendon se nëpërmjet ankimit të ushtruar nga Komisioneri, subjekti i rivlerësimit ngarkohet me një barrë të pakapërcyeshme të provave, në kundërshtim me nenin 6 të KEDNj-së⁶⁸. Për të mbështetur këtë pretendim, si tregues që sipas tij, përbën shkelje të parimeve të gjykimit të drejtë [neni 6 i KEDNj-së], subjekti referon *vendimin e GjEDNj-së në çështjen Othman (Abu Qatada) kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

22.2. Trupi gjykues sjell në vëmendje disa aspekte që rezultojnë pas analizës së këtij pretendimi. *Së pari*, sipas Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, respektivisht neneve Ç, pika 5 dhe 52, pika 2, barra e provës në procesin e rivlerësimit u përket subjekteve të rivlerësimit. Siç është

⁶⁷ Konkretisht, shpenzimet e subjektit për qiranë në Shqipëri në vitet 2014 dhe 2015, shpenzime udhëtimi dhe transporti sendesh personale dhe dhurimin nga familjet respektive të secilit prej bashkëshortëve Gramshi, shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të subjektit në shkollën private për vitin 2015.

⁶⁸ Subjekti referon vendimet e GjEDNj-së: *Dimitrov kundër Bullgarisë*, *Gogidite kundër Gjeorgjisë*, parag. 107-108.

arsyetuar gjerësisht në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar gjendjen e pamundësisë objektive për të ardhurat e një periudhe kohore, kërkesë e shprehur e nenit 32, pika 2, e pa përmbushjen e së cilës nuk mund të konkludohet pamundësi objektive. Konkretisht, subjekti nuk provoi në asnjë formë se dokumentet janë kërkuar dhe nuk janë prodhuar nga institucionet për shkaqe përtej kontrollit të tij. Për rrjedhojë, “pakapërcyeshmëria” e pretenduar e barrës së provave, është një pretendim të cilit i mungon themeli.

22.3. *Së dyti*, ky pretendim nuk qëndron edhe për arsyet e shtjelluara në detaj më sipër: subjekti nuk ishte asnjëherë koherent për nëse ka fituar të ardhura në periudhën kohore 2003-2005, duke ndërruar pretendimet sipas rrethanave. Si shembull, subjekti ka pretenduar se kishte pasur probleme shëndetësore të rënda në këtë periudhë, në momentin kur ka kërkuar dorëheqjen në vitin 2004, ka pretenduar të ardhura të mjaftueshme dhe punësim të vazhdueshëm në procesin e hetimit administrativ, dhe së fundmi, ka pretenduar të ardhura në nivel modest mbijetese e me *cash-in* e marrë nga Shqipëria, në procesin gjyqësor në Kolegj. Në pikën fundore, pavarësisht se cilat pretendime pasqyrojnë të vërtetën, përjashtohet mundësia që të ardhurat, në çfarëdo vlere, të kalojnë testin e ligjshmërisë së përcaktuar nga neni D i Kushtetutës.

22.4. *Së treti*, ankimi i Komisionerit bazohet *kryekëput* në rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni, mbi bazën e të njëjtave akte në fashikull, me të cilat subjekti është njohur, ka dhënë shpjegime e prova dhe ka ushtruar të drejtat e garantuara prej Kushtetutës [dhe nenit 6 të KEDNj-së] për një proces të rregullt. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se ky pretendim i subjektit – se barra e provës është e pakapërcyeshme – është alogjik, pasi në thelb konteston vlerësimin e ndryshëm të fakteve dhe provave nga Komisioneri Publik. Në këto kushte, ky pretendim paraqitet si një keqinterpretim i vullnetshëm që favorizon përgatitjen e hapave të mëtejshëm. Subjekti ka qenë i ndërgjegjshëm gjatë gjithë procesit të rivlerësimit për faktin që barra e provës do t’i kalonte atij për të provuar sa ka deklaruar, dhe ai rezulton të ketë qenë dakord me procesin, për sa kohë konkluzionet kanë qenë në favor të tij. Pretendimi i subjektit se ka pasur barrë prove të pakapërcyeshme, si rrjedhojë e shkaqeve të ankimit që janë të bazuara në ligj dhe në zbatim të detyrës kushtetuese të Komisionerit Publik, në procesin në Kolegj, për këtë arsye, duket i diktuar dhe në funksion të mbrojtjes që subjekti ka zgjedhur në këtë fazë të procesit.

22.5. *Së katërti*, nëpërmjet jurisprudencës së saj, GjEDNj-ja ka konsoliduar vlerësimin që neni 6 i KEDNj-së nuk parashikon asnjë rregull mbi pranueshmërinë e provave ose mënyrën e vlerësimit të tyre, të cilat kryesisht rregullohen nga legjislacioni i brendshëm kombëtar dhe gjykatat e vendit⁶⁹. U takon gjykatave kombëtare të vlerësojnë rëndësinë e provave, vlerën e tyre provuese dhe barrën e provës⁷⁰. Sa i përket barrës së provës në procesin e *vetting*-ut, përfshirë

⁶⁹ *Shih Garcia Ruiz kundër Spanjës, paragrafi 28.*

⁷⁰ *Shih Centro Europa 7 S.R.L dhe Di Stefano, paragrafi 198; Lady S.R.L kundër Moldavisë, paragrafët 27, 23; Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafi 325.*

mungesën e kufijve të rreptë kohorë për vlerësimin e pasurisë, GjEDNj-ja ka vlerësuar se nuk përbëjnë shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, por duhet të merren parasysh rast pas rasti⁷¹.

22.6. *Së fundmi, në Othman (Abu Qatada),* GjEDNj-ja ka gjetur që ekzistenca e një mohimi flagrant të drejtësisë, siç pretendonte kërkuesi, karakterizohet nga shkelje thelbësore të parimeve të gjykimit të drejtë, të tilla që bëjnë nul ose shkatërrojnë thelbin e së drejtës së garantuar nga neni 6 i KEDNj-së. Në këtë kontekst, gjykata arriti në përfundimin se *dëbimi* i kërkuesit në Jordani për t'u rigjykuar, do të përbente një mohim flagrant të drejtësisë dhe shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, për shkak të rrezikut real të pranimit të provave të marra nga *tortura* e palëve të treta në rigjykimin e kërkuesit. Nisur nga referimi në këtë çështje, pretendimi i subjektit për barrë prove të pakapërcyeshme, si ekuivalente të një shkeljeje thelbësore të parimeve të gjykimit të drejtë, si ai i gjetur nga GjEDNj-ja për shkak të dëbimit të kërkuesit dhe në kushtet kur rrezikonte të përballej me prova të marra nga *tortura*, është i pavend dhe i pakuptimtë. E drejta kushtetuese e Komisionerit Publik për të ushtruar ankim në procesin administrativ të rivlerësimit, duke paraqitur një vlerësim të ndryshëm të konkluzionit të Komisionit dhe të provave të sjella në masë të madhe nga vetë subjekti, për pasuri të deklaruar nën përgjegjësi prej tij, e bën të pamundur dhe alogjik paralelizmin me vlerësimin e GjEDNj-së në *Othman*, për mohim flagrant të drejtësisë.

22.7. Duke theksuar natyrën e procesit të rivlerësimit dhe mënyrën se si mundësohet kontradiktorialiteti, përpos parimeve të tjera të procesit të rregullt, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se edhe duke e thjeshtuar krahasimin me *Othman*, pretendimi i subjektit për pamundësi objektive, pa përmbushur kriteret e ligjit dhe pa sjellë asnjë provë në një proces të cilit i është nënshtruar me vullnet të lirë, i cili ia njeh atij barrën e provës për të provuar sa pretendon, nuk mund të argumentohet se ngjan me situatën e një të pandehuri i cili pritej të përballej me prova të marra nën torturë, në një proces mbi të cilin nuk kishte asnjë kontroll qoftë për t'iu nënshtruar, qoftë për të parandaluar marrjen e provave inkriminuese. Për të njëjtën logjikë, duke qenë se në procesin e rivlerësimit, një proces administrativ, nuk ngrihen "akuza" ndaj subjekteve, mënyra e interpretimit të subjektit që kërkon të prezantojë kalimin e barrës së provës si të shoqëruar me të drejtën e tij për ta kundërshtuar këtë kalim, vlerësohet e pabazuar, referuar parashikimeve të pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016⁷².

- 23.** Po ashtu, në kontekstin e të drejtave për proces të rregullt, subjekti i rivlerësimit ka kontestuar atë që, sipas tij, përbën "mungesë hetimi proaktiv" nga ana e vëzhguesve ndërkombëtarë. Sipas subjektit, vëzhguesit nuk kanë ushtruar hapësirat e parashikuara në paragrafin 3 të nenit B dhe në paragrafin 4 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikat 1 dhe 7 të nenit 50 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit gjen që edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar dhe një përpjekje për të evituar përgjegjësitë e tij në procesin e rivlerësimit, të cilit i është nënshtruar me vullnet.

⁷¹ *Shih Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafët 348, 53.*

⁷² *Ligji nr. 84/2016, në pikën 2, neni 52, "Barra e provës", parashikon se: "2. Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën".*

23.1. Nga leximi harmonik i dispozitave kushtetuese dhe ligjore që normojnë rolin dhe detyrat e ONM-së dhe vëzhguesve, rezultojnë qartë përgjegjësitë për monitorimin dhe mbikëqyrjen e procesit, në funksion të respektimit të garancive të procesit të rregullt, ndër të tjera. Siç është theksuar më sipër, barra e provës në procesin e rivlerësimit, është përgjegjësi e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen këtij procesi me vullnetin e tyre. Fakti që ligji nr. 84/2016 parashikon rrethana specifike në të cilat vëzhguesit ndërkombëtarë [dhe Komisioni e Kolegji] gëzojnë të drejtën të kërkojnë informacion nga entitete shqiptare ose të huaja⁷³ apo mund të kërkojnë të dhëna nëpërmjet mekanizmave të ndihmës juridike ndërkombëtare⁷⁴, në funksion të hetimit të thelluar dhe të zgjeruar, apo kur ndihmon efikasitetin e hetimit kryesisht, nuk mund të argumentohet se përbën detyrë hetimi “proaktiv” që çliron subjektet e rivlerësimit nga përgjegjësia kushtetuese që të mbajnë barrën e provës për të provuar sa deklarojnë. Nën këtë dritë, paraqitja e dokumenteve është parashikuar si përgjegjësi ligjore e subjekteve, për të provuar deklaratimet e pasurive në mënyrë të shprehur në nenin 32, pika 1, sikurse edhe në frymën e pjesëve të tjera të së njëjtës dispozitë⁷⁵.

23.2. Për sa prej subjektit në Komision nuk është përmbushur barra e provës, si dhe nuk është paraqitur asnjë dokument që të mund të shërbente qoftë dhe si indicie për pretendimin e tij për punësim në vitet 2003-2004, duke abstraguar nga kundërthëniet që bëjnë të pamundur besueshmërinë e secilit variant faktesh, delegimi i këtij detyrimi të subjekteve të rivlerësimit ONM-së, siç nënkupton në thelb ky pretendim, përveçse bie ndesh me ligjin, do ta vendoste në një ngërç procesin e rivlerësimit. Kjo është edhe arsyeja përse ligjbërësi ka parashikuar detyrimin e paraqitjes së dokumenteve justifikuese ligjore në nenin 32, pika 1, për subjektet e rivlerësimit. Për pasojë, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar dhe përbën një përpjekje të subjektit për të evituar përgjegjësitë e tij në procesin e rivlerësimit.

24. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioneri Publik nuk ka interpretuar drejt nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sa i përket kuptimit të konceptit të deklaratimit të pamjaftueshëm, i cili duhet të lidhet njëkohësisht si me kriterin e pasurisë, ashtu edhe me kriterin e figurës, trupi gjykues sjell në vëmendje së pari, formulimin e nenit 61, në të cilin parashikohen situata ligjore autonome, të cilat u korrespondojnë dispozitave të veçanta të Aneksit të Kushtetutës, konkretisht neneve D, Dh dhe E, interpretuar gjerësisht tashmë në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit⁷⁶. Nën dritën e këtyre dispozitave, Kolegji në mënyrë të vazhdueshme, ka theksuar se

⁷³ Neni 51, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon që: “[...] Komisioni, Kolegji i Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë bashkëpunojnë me organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, për të verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklaratimeve të bëra nga subjektet e rivlerësimit [...]”.

⁷⁴ Pika 7, neni 51 i ligjit nr. 84/2016 parashikon që: “[...] 7. Komisioni, Kolegji i Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë të drejtë të kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar brenda kuadrit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në rrugë diplomatike. Kërkesat trajtohen nga ministria përgjegjëse [...]”.

⁷⁵ Neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon që: “[...] Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklaratimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...]”.

⁷⁶ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit: nr. 9 (JR), datë 24.10.2018; nr. 7 (JR), datë 05.04.2019; nr. 28 (JR), datë 30.10.2019; nr. 34 (JR), datë 15.11.2021 etj.

vlerësimet për secilin kriter rivlerësimi (atë të pasurisë dhe pastërtisë së figurës) janë të pavarur nga njëri-tjetri dhe mund të çojnë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit të rivlerësimit për kriterin objekt shqyrtimi, vlerësohet i pamjaftueshëm.

25. Për sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 519, datë 25.3.2022, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi, nuk është i bazuar dhe duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 519, datë 25.03.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 02.03.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi – kundër

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi – kundër

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Ina Rama, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues në çështjen që i përket ankimit të Komisionerit Publik Florian Ballhysa, kundër vendimit nr. 519, datë 25.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), vendim i cili kishte konfirmuar në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, subjektin e rivlerësimit Kastriot Gramshi. Në konkluzion të qëndrimit tim, kam votuar kundër vendimit nr. 8, datë 02.03.2023, të marrë prej shumicës së trupit gjykues për ndryshimin e vendimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duke mbajtur qëndrimin se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi, duhej të lihej në fuqi.
2. Qëndrimi im i pakicës kundër vendimit të shumicës do të përqendrohet në evidentimin e atyre fakteve dhe rrethanave që lidhen me analizën financiare të kryer për kontrollin e burimeve të ligjshme të përdorura nga subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij, për krijimin e dy pasurive, një shtëpie që figuron në pronësi të subjektit dhe vëllait të tij; të depozitave bankare në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes dhe në vlerësimin e peshës së konkluzioneve për deklaram të pasaktë të pasurisë, të kryer prej subjektit të rivlerësimit.
3. Kam ndarë qëndrime të njëjta me shumicën për sa u përket konkluzioneve se subjekti gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, lidhur me deklaramet e tij në deklaratën *vetting* për vlerën e kredisë së përdorur për financimin e pasurisë, shtëpi me sipërfaqe 180 m², të ndodhur në New York të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (në vijim “ShBA”), si dhe për sa i përket konkluzionit se subjekti nuk gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 lidhur me pamundësinë për të provuar me dokumentacion të ardhurat për periudhën 2003-2004. Kam ndarë gjithashtu të njëjtin qëndrim si shumica edhe për sa i përket shtrirjes së kontrollit për kriterin e pasurisë, edhe për periudhën 2003-2004, sipas pretendimit të Komisionerit Publik. Pavarësisht këtyre konkluzioneve të njëjta të arritura në pikën fundore të arsyetimit të kryer nga shumica, nuk kam të njëjtën qasje dhe vlerësim për peshën që këto konkluzione duhet të kenë në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjektit, duke mbajtur qëndrimin se ato duhet të vlerësohen në zbatim të parimeve të proporcionalitetit dhe objektivitetit sipas parashikimeve të neneve 4, pika 5 dhe 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, mbështetur në të gjitha argumentet që do shtrohen në vijim të këtij mendimi.
4. Përtej kontrollit të vërtetësisë dhe saktësisë së deklarameve, kam vlerësuar të rëndësishme për vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, analizën financiare që duhej të kryhej për të kontrolluar nëse ai ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë në pronësi të tij, të deklaruar si të tillë në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në thelb të këtij procesi, me rëndësi thelbësore për të arritur një nivel të besueshëm të kriterit të pasurisë, është kontrolli i burimeve të ligjshme që kanë përdorur subjektet për të krijuar pasuritë e tyre, duke përfshirë brenda këtij kontrolli edhe llogaritjen e çdo shpenzimi të dokumentuar se ka ndodhur për nevoja të jetesës së tyre si një zë logjik i një analize matematikore, por edhe përllogaritjen e shpenzimeve të kryera për jetesë sipas standardeve të pranura në metodologjinë e organeve të

rivlerësimit, si një referim i gjithëpranuar, që mundëson trajtimin e barabartë të subjekteve, pavarësisht se sa ky standard i afrohet të vërtetës jetësore të tyre, qoftë kjo në drejtim të favorizimit apo dëmtimit të interesave pasurorë të subjekteve gjatë këtij procesi.

5. Në vijim të kësaj logjike, kam vlerësuar se në kryerjen e analizës financiare për të kontrolluar burimet e ligjshme të përdorura nga subjekti dhe familja e tij për financimin e dy pasurive të krijuara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përgjatë periudhës së qëndrimit atje si emigrant, duhej konsideruar si një zë i zbritshëm në kategorinë e shpenzimeve të jetesës, vlera që në këto shpenzime zinte zëri i qirasë së paguar për banim.
6. Subjekti ka deklaruar përgjatë hetimit administrativ se ka paguar qira për banesën ku ka jetuar me familjen e tij në vitet 2003-2010, vlerën prej 1500 USD në muaj dhe në vitet 2010-2012 (deri në maj të vitit 2012, kohë kur ai blen shtëpinë objekt kontrolli), vlerën prej 1800 USD në muaj. Ai është ngarkuar me këtë shpenzim në analizën financiare të kryer si nga Komisioni, ashtu edhe nga Kolegji për të kontrolluar burimet e ligjshme të krijimit të pasurive të tij, të pretenduara prej Komisionerit Publik se duhej t'i nënshtroheshin juridiksionit kontrollues të Kolegjit.
7. Krahas këtij shpenzimi, si zë më vete, përllogaritur në këtë analizë, rezultojnë të jenë edhe vlerat korresponduese të kostove për shpenzime jetese sipas të dhënave të zyrës së censusit në ShBA, duke përdorur të njëjtin standard si me subjekte të tjera rivlerësimi kur i janë nënshtuar kontrollit të pasurive apo shpenzimeve të jetesës për raste të jetesës së kryer jashtë vendit. Rezultatet e analizës financiare të konkluduara prej vendimit të shumicës, në vlerat (-) 16.000 USD, si një vlerë negative e akumuluar për periudhën 2003-2012, deri në momentin e blerjes së pasurisë shtëpi, dhe në vlerën e akumuluar prej (-) 25.863 USD, për periudhën 2003 - 10.07.2015, deri në momentin e deklarimit fillestar, në të cilën përfshihet edhe përllogaritja e krijimit të dy depozitave bankare të subjektit, janë nxjerrë duke ngarkuar subjektin me shpenzime për qiranë, për vlerën e deklaruar prej atij vetë, por edhe për vlerën korresponduese që i përket këtij zëri në kategorinë e shpenzimeve të jetesës sipas të dhënave të zyrës së censusit në ShBA.
8. Përgjatë gjykimit në Kolegj, ndër të tjera, subjekti pretendoi edhe zbritjen nga zëri “shpenzime jetese” të vlerës korresponduese të qirasë, e cila është përllogaritur në analizën financiare të kryer edhe si shpenzim më vete, sipas vlerave të përcaktuara prej subjektit e të cituara më lart.
9. Referuar të dhënave zyrtare të institucionit përgjegjës, zëri “qira” në koston e shpenzimeve të jetesës në ShBA, zë në varësi të viteve, nga 35% - 36% të vlerës totale të këtyre shpenzimeve të përllogaritura në analizën financiare.
10. Kam vlerësuar se ky pretendim i subjektit duhej të konsiderohej dhe njësisht e shërbimit ligjor në Kolegj ta vlerësonte atë në analizën financiare të kryer. Nuk kam qenë dakord me qëndrimin e mbajtur prej shumicës se, meqenëse ky pretendim i subjektit është ngritur për herë të parë në Kolegj, ai nuk duhej konsideruar si i bazuar. Subjektet thirren në gjykimin publik në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, kur ndaj vendimeve të tyre për konfirmimin në detyrë, ka ushtruar ankim

Komisioneri Publik, në një seancë gjyqësore publike, pikërisht për të garantuar të drejtën e tyre për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar përkundrejt të gjitha shkaqeve të ankimit të ngritura nga Komisioneri. Neni F, pika 7 e Aneksit të Kushtetutës, si edhe neni 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, të cilët parashikojnë detyrueshmërinë e seancës gjyqësore publike dhe garantimin e kontradiktoritetit të procesit gjyqësor, kur ankues është Komisioneri Publik, u japin, në vlerësimin tim, subjekteve të drejtën të mbrohen ndaj çdo çështjeje, këndvështrimi apo shkaku ligjor të ri të ngritur në ankim, në mënyrë të pakufizuar dhe në funksion të garantimit të së drejtës së tyre për t'u mbrojtur.

11. Qëndrimi se subjekti, pavarësisht se është përballur në Komision me një analizë financiare negative në rezultatet e hetimit, nuk e ka ngritur një pretendim të tillë, nuk mund të shmangë Kolegjin nga konsiderimi i çdo pretendimi të ngritur rishtas karshi një panorame të re negative, me të cilën subjekti përballlet nëpërmjet ankimit. Sipas një logjike të thjeshtë, subjekti ka paraqitur në Komision një sërë arsyesh pse analiza e kryer nga ky organ ishte e gabuar, duke besuar se ato kanë qenë të mjaftueshme për ta pasur një rezultat të pritshëm pozitiv. Fakti që sipas ankimit, këto arsye e prova të paraqitura nuk mjaftojnë për të konfirmuar rezultatin pozitiv, ose nuk vlerësohen si të tilla, do të duhej që normalisht të aktivizonin subjektet drejt një argumenti shtesë apo paraqitjes së provave të reja për të konfirmuar atë që tashmë Komisioni kishte arritur në konkluzion. Në këtë kuptim, në procesin gjyqësor në Kolegj, subjektet ftohen të paraqesin prova të reja, dhe ato pranohen si të tilla nga Kolegji, pikërisht për t'i dhënë dritë zbatimit të parimit të kontradiktoritetit dhe garantimit të një procesi të rregullt ligjor.
12. Përpos këtij arsjetimi, pretendimi i subjektit në këtë rast, nuk lidhej me ndonjë fakt juridik të deklaruar prej tij se ka ndodhur, të cilin ai e kishte modifikuar në raport me qëndrimet e mëparshme, por lidhej me konsiderimin/vlerësimin e një zëri të vendosur në analizë sipas një standardi të referuar nga institucionet përkatëse dhe jo të deklaruar prej vetë subjektit. Ai ka ftuar Kolegjin, nëpërmjet pretendimit të tij, të vlerësojë në mënyrë objektive një të dhënë që vjen si një standard ligjor, i cili prezumohet se ka afektuar edhe situatën financiare të vetë subjektit, por që nuk është një fakt i provuar nëpërmjet llojeve të provave që parashikon ligji nr. 84/2016 në nenin 49 të tij. Në vlerësimin tim, kam gjetur të drejtë këtë qëndrim të subjektit dhe të padrejtë qëndrimin e shumicës që nuk ka përllogaritur në analizën financiare këtë pretendim të arsyeshëm dhe objektivisht të qenësishëm të subjektit, duke ngarkuar në këtë mënyrë subjektin, dy herë me të njëjtin shpenzim për qiranë, edhe sipas vlerës së deklaruar prej tij, edhe sipas zërave të përfshirë në koston e shpenzimeve të jetesës sipas të dhënave zyrtare, aq më tepër kur përqindja që kjo vlerë zë në këto shpenzime është e rëndësishme dhe e ndjeshme në përllogaritjen e shpenzimeve, duke qenë se varion në vite në vlerat 35% - 36% të totalit të shpenzimeve për jetesë.
13. Nga përllogaritja e kryer mbi këtë logjikë nga Njësia e Shërbimit Ligjor, janë evidentuar dy elemente të rëndësishme në vlerësimin tim, *së pari* se vlera e deklaruar prej subjektit si e shpenzuar për pagimin e qirasë, është gati dyfish më e lartë se ajo që i përket këtij zëri sipas raportit që ajo

zë në shpenzimet e jetesës së zyrës të censusit në ShBA⁷⁷, fakt që tregon për sinqeritetin e subjektin në deklarimin që ka kryer për këtë shpenzim, ndonëse një shpenzim krejtësisht i pagjurmueshëm prej organeve të rivlerësimit. *Së dyti*, nga përlogaritja e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, duke zbritur nga zëri i shpenzimeve të jetesës vlerën e përqindjes që zë komponenti i shpenzimeve për qira në raport me vlerën totale të shpenzimeve të jetesës që rezultojnë në masën 35% - 36%⁷⁸, rezultati financiar i analizës ndryshon krejtësisht në një balancë pozitive, në vlera dukshëm të larta, duke përmbysur të gjitha balancat negative që kanë rezultuar nga analiza e kryer në Kolegj, pa e aplikuar këtë zbritje.

14. Analiza financiare për subjektin e rivlerësimit, duke ruajtur të gjitha vlerat e tjera sipas atyre të pranuar nga shumica dhe duke ndryshuar vetëm këtë të dhënë të analizës financiare, rezulton të shndërrohet nga një balancë negative akumulative, respektivisht (-) 16.000 USD për periudhën 2003-2012, dhe për balancën tjetër negative akumulative në (-) 25.863 USD, në një balancë pozitive prej (+) 50.000 USD, nëse kjo përlogaritje do të bëhej deri në muajin maj 2012, kur subjekti blen shtëpinë objekt kontrolli. Kjo balancë do të mbetej pozitive në vitet në vijim edhe në rast se përlogaritja e shpenzimeve të jetesës do të vijonte të konsiderohej e pazbritshme për zërin shpenzime qiraje, ndonëse subjekti nga maji i vitit 2012 nuk shpenzonte më për këtë qëllim, për shkak se e kishte zgjidhur tashmë strehimin nëpërmjet shtëpisë së blerë, në bashkëpronësi të tij dhe të vëllait të tij.
15. Mbi këtë ndryshim të rëndësishëm të rezultatit financiar, kam arsyetuar dhe vlerësuar si të pasigurt rezultatin e pranuar nga shumica, duke vënë në pikëpyetje të gjithë vlerësimin financiar që u është bërë burimeve të subjektit të rivlerësimit, duke rrezikuar një gabim të rëndësishëm në vlerësimin e burimeve të përdorura për krijimin e pasurive të tij. Në këtë kontekst, kam konsideruar dhe interpretuar edhe parashikimin e nenit 32, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *Nëse subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur kanë pasuri jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ai paraqet deklaratimet bankare të viteve të fundit, të dhënat e fundit mbi regjistrimin e pasurisë ose dokumente të tjera që tregojnë vlerën e pasurive që ndodhen jashtë shtetit.* Ky parashikim duket se ka konsideruar një standard të ndryshëm të provueshmërisë dhe thellimit të hetimit për pasuri të krijuara jashtë vendit, në vlerësim tim, pikërisht në konsideratë të faktit se për krijimin e tyre zbatohen regjime të ndryshme ligjore, legjisllacione të pamundura për t'u njohur e zotëruar prej organeve të rivlerësimit në mënyrë të plotë, vështirësi në aksesimin e dokumentacionit që provon krijimin e pasurive, vështirësi në hetimin e çdo fakti jetësor apo financiar të ndodhur, që mund të afektojë vlerësimin e pasurive të subjekteve. Duket se vetë ligjvënësi nëpërmjet kësaj dispozite, ka dashur të tërheqë vëmendjen e organeve të rivlerësimit në drejtim të një vlerësimi objektiv në këto raste, pikërisht për shkak të faktit se ngarkimi me barrë prove i subjekteve në nivel të njëjtë si kur pasuritë janë krijuar në territorin shqiptar, në të cilin

⁷⁷ CPS Historical Poverty Footnotes (census.gov):

<https://www.census.gov/topics/income-poverty/poverty/guidance/poverty-footnotes/cps-historic-footnotes.html>.

⁷⁸ Sipas viteve në të cilat janë përcaktuar këto raporte të dhëna nga faqja zyrtare e "BUREAU OF LABOR STATISTICS USA" (www.bls.gov).

organet e rivlerësimit kanë të drejtë të aksesojnë çdo të dhënë qeveritare dhe private sipas parashikimit kushtetues të nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, është joproportional dhe për këtë shkak, mund të provokojë një konkluzion të gabuar, me pasoja të rëndësishme në drejtim të jetës profesionale të subjekteve. Këtij argumenti, i cili u përket të gjithë subjekteve që kanë krijuar pasuri jashtë vendit përgjatë kohës që kanë qenë subjekte deklaruese sipas ligjit nr. 9049, datë 10.03.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), duhet t’i shtohet, në vlerësimin tim, në rastin konkret, edhe fakti që subjekti e ka krijuar këtë pasuri jo vetëm jashtë vendit, por edhe përgjatë kohës që jetonte atje si emigrant dhe nuk kishte asnjë detyrim sipas ligjit shqiptar për deklarim të pasurisë.

16. Konkluzionet e mësipërme i kam vlerësuar në raport me qëndrimin e mbajtur prej shumicës së subjekti ka bërë deklarime të pasakta në deklaratën e pasurisë *vetting*, për sa u përket deklarimeve rreth vlerës së kredisë dhe pagesës së këstit të dytë për pagimin e çmimit të shtëpisë së blerë në shtetin e New York-ut, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Pjesë e këtij vlerësimi janë bërë argumentet të cilat do të renditen më poshtë e që më kanë çuar në konkluzionin e ndryshëm nga shumica, se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, është joproportionale dhe nuk i përgjigjet qëllimit të procesit të rivlerësimit.
17. *Së pari*, pasuria shtëpi banimi, e cila merret në analizë, është një pasuri e përbashkët e subjektit të rivlerësimit dhe e vëllait të tij, e cila për më tepër është financuar, siç është pranuar edhe nga shumica, nga të ardhurat e gjithë familjes së subjektit, duke qenë se edhe është përdorur nga të gjithë anëtarët për nevoja të strehimit. Blerja dhe financimi i kësaj pasurie ka ndodhur në vitin 2012, gati nëntë vite pasi subjekti kishte lënë detyrën e gjyqtarit dhe ishte vendosur në ShBA, dhe dy vjet para se ai të rikthehej në Shqipëri për të rifilluar të ushtronte funksionet e gjyqtarit⁷⁹.
18. Faktet e mësipërme, sipas vlerësimit tim, e zhvlerësojnë dyshimin se subjekti ka përdorur për të krijuar pasurinë e tij dhe të familjes, para të përfituara nëpërmjet ushtrimit të detyrës deri në vitin 2003, por që i mbajti të papërdorura deri në vitin 2012. Analiza që i bëhet mosdorëzimit të deklaratës fillestare të pasurisë në vitin 2003 prej subjektit të rivlerësimit, përveç se është një element për të cilin Komisioneri Publik nuk ka paraqitur ankim, ka në vlerësimin tim një kontekst historik që duket se i jep kuptim mosveprimit, pavarësisht se, në kuptim formal, subjekti kishte detyrimin të deklaronte, duke qenë se në mars të vitit 2003, ishte ende gjyqtar i emëruar në detyrë.

⁷⁹ *Situata e potencuar në vendim, se subjekti kishte punuar për rreth 5 vite si gjyqtar para se të largohej nga vendi, nuk rezultoi të jetë e saktë, pasi subjekti ka punuar një vit si gjyqtar në stazhin profesional të Shkollës së Magjistraturës në vitin 1999-2000 dhe në kuptim të ligjit, ai ka gjykuar vetëm çështje të lehta brenda kontekstit të programit akademik dhe nën kujdesin e një gjyqtari në detyrë, dhe më pas ka punuar për gati tri vite, tetor 2000 - korrik 2003, si gjyqtar i emëruar në detyrë, ndërsa viti i pestë i pasjes së statusit, deri në korrik 2004, kur KLD-ja ka miratuar dorëheqjen e tij, është një periudhë pa relevancë dhe pa peshë në kuptim të viteve të punës si gjyqtar, referuar kontekstit të rivlerësimit, përderisa subjekti është larguar për në ShBA dhe nuk është kthyer më asnjë ditë për të ushtruar funksionet e tij, deri në vitin 2014.*

19. Subjekti ka dhënë dorëheqjen nga detyra e gjyqtarit, në muajin prill të vitit 2004, vetëm një muaj pas mbarimit të afatit për të plotësuar deklaratën fillestare të pasurisë, ndërsa logjikshëm mendohet se vendimi për këtë dorëheqje, nuk është marrë pas kalimit të muajit mars, por në një kohë më të hershme, përderisa subjekti kishte nisur procedurat për fitimin e statusit të azilantit polik në ShBA, me mbërritjen e tij atje, fakt që flet për ndërgjegjësimin dhe vendimin për të qëndruar në atë vend. Në këto rrethana, ndonëse mosplotësimi i deklaratës fillestare përfaqëson shkelje të përcaktimeve e detyrimeve ligjore në kuptimin formal për subjektin e rivlerësimit, në kuptimin substancial, kjo sjellje e subjektit nuk mund të ketë peshën e paragjyqimit se është kryer për t'iu shmangur kontrollit të pasurive, ndërsa duket më shumë si një shkujdesje apo pakujdesi në plotësimin e detyrimeve ligjore që buronin nga një status, i cili *de facto* ishte humbur që në korrik të vitit 2003 dhe *de jure* humbi pasi u manifestua vullneti i subjektit për dorëheqje, vetëm një muaj pas përfundimit të afatit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë.
20. Situata e pretenduar prej subjektit se duhet të kualifikohej sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tim, ndonëse nuk plotësonte kërkesat e kësaj dispozite për sa u përket përpjekjeve të subjektit për të marrë informacion prej institucioneve që provonin të ardhurat e krijuara prej tij në periudhën 2003-2004, nuk mund të rëndojë me përgjegjësi subjektin, duke arsyetuar se ai nuk ka bërë përpjekjet e duhura dhe me qëllim nuk i ka marrë ato që në vitin 2014, kur ai deklaroi për herë të parë pas marrjes së detyrës. Dispozitat e ligjit nr. 9049/20003 nuk detyronin përcjelljen e dokumentacionit që provonte të ardhurat e krijuara përgjatë gjithë jetës prej subjekteve deklaruese, por vetëm ato që kishin shërbyer për krijimin e pasurive të deklaruara. Në këtë kuptim, subjekti nuk kishte detyrimin të paraqiste në atë kohë dokumentacionin i cili, më pas, duhej të paraqitej para organeve të rivlerësimit në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, analiza për sjelljen e subjektit, sipas vlerësimit tim, duhet të bëhet në referim të këtyre afateve, dhe përgjegjësia e subjektit, e cila përjashton zbatimin e nenit 32, pika 2 e ligjit, lidhet me mungesën e përpjekjeve që ai ka bërë me dorëzimin e deklaratës *vetting*, për të marrë këtë dokumentacion dhe për t'ua servirur atë organeve të rivlerësimit. Qëndrimi i subjektit se për shkak të afateve ligjore të superuara, nuk gjendet më informacioni, nuk përfaqëson kriterin ligjor për kualifikimin e një shtetasi si në kushtet e pamundësisë objektive. Prezumimi ligjor i mosruajtjes së akteve, nuk shkarkon subjektin nga barra që ai ka për t'i kërkuar ato prej institucioneve/enteve përkatëse, përgjigjet negative të të cilave, në harmoni me parashikimet ligjore, do të kualifikonin situatën sipas nenit 32, pika 2 e ligjit. Për sa kohë që subjekti nuk provon përpjekjet e tij, për të siguruar këtë informacion, zbatimi i kësaj dispozite mbetet i pamundur.
21. Pavarësisht këtij arsytimi, kam vlerësuar se vetë neni 32, pika 3 e ligjit, duket se përshkruan dhe rregullon pikërisht specifikën e rastit kur pasuritë janë krijuar jashtë vendit dhe pamundësinë e organeve për të saktësuar në këto raste se ku mbaron barra e provës për subjektin e rivlerësimit dhe ku fillon pamundësia objektive për të siguruar dokumentacion në një vend të huaj, me regjim juridik të ndryshëm dhe të panjohur për organet e rivlerësimit.

22. Në vlerësim dhe analizë të të gjitha argumenteve më sipër përmendur, kam konsideruar objektivisht të pamundur një konkluzion definitiv mbi rrethanat e krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit përgjatë kohës që ai së bashku me familjen e tij kanë jetuar jashtë vendit, duke pasur parasysh gjithashtu se familja rezulton të ketë pasur, përveç të ardhurave të përfituara në ShBA, edhe të ardhura të tjera të përfituara nga aktivitetet e biznesit, të cilat kanë vijuar pa ndërprerje aktivitetin në Shqipëri, sipas të dhënave të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës⁸⁰ dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve⁸¹. Në këto kushte dhe duke konsideruar si të pranueshëm një version të analizës financiare si ajo e përshkruar më lart, e cila e vë subjektin në kushtet e pasjes së mundësive për të krijuar me burime të ligjshme pasuritë e deklaruar prej tij, si edhe duke vlerësuar, në zbatim të parimit të proporcionalitetit, peshën/ndikimin e deklarimeve të pasakta të subjektit, për të cilat ka konkluduar edhe shumica, kam arritur në konkluzionin se subjekti ka kaluar testin e nivelit të besueshëm të krijimit të pasurive të tij.
23. Në zbatim të parashikimit të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, kam vlerësuar se niveli i justifikimit të pasurive me burime të ligjshme duhet të konsiderohet se është bindës dhe si i tillë, subjekti me të drejtë është konfirmuar në detyrë nga Komisioni.
24. Për sa më lart, kam votuar për lënien në fuqi të vendimit nr. 519, datë 25.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

⁸⁰ Nr. {***} prot., datë 04.10.2021, e cila jep informacion në lidhje me subjektin tatimor “{***}” ShPK, me ortak subjektin e rivlerësimit.

⁸¹ Nr. {***} prot., datë 12.05.2020, e cila jep informacion në lidhje me subjektin tatimor “{***}” ShPK, me ortak dhe administrator babain e subjektit të rivlerësimit.

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam për lënien në fuqi të vendimit nr. 519, datë 25.03.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi dhe në ndryshim nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit kam votuar kundër kërimit të ankimit të Komisionerit Publik dhe vendimit nr. 8, datë 02.03.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, për arsytet si më poshtë.
2. Komisioni, në vlerësimin e tij për kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm, sipas shkronjës “a”, pika 1, neni 59 të ligjit nr. 84/2016. Kështu, subjekti i rivlerësimit:
 - ka kryer deklarime të sakta në deklaratën *vetting* dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e rivlerësimit;
 - pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore nuk rezultuan të kenë qenë të qëllimshme apo të kenë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklarime të rreme;
 - nuk rezultoi të ketë qenë në ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit;
 - nga hetimet e thelluara edhe për deklarime të kryera pas deklaratës *vetting*, në lidhje me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve të kryera përpara kësaj deklarate nga ana e subjektit dhe personave të lidhur, rezultoi se ka qenë në koherencë të plotë dhe në vijueshmëri të deklarimeve nga viti 2014, kur subjekti ka rifilluar të ushtrojë detyrën e gjyqtarit dhe deri në deklaratën *vetting*.
3. Komisioneri Publik, bazuar në rekomandimin e ONM-së, me nr. {***} prot., datë 16.05.2022, ka ankimuar vendimin e Komisionit vetëm për kriterin e pasurisë, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë. Shkaqet e ankimit i referohen:
 - a) saktësisë dhe mjaftueshmërisë financiare për periudhën shtator 2003 – 21.05.2012, për pagesat e këstit të parë dhe të dytë në vlerën rreth 16.000 USD, lidhur me pasurinë e deklaruar në deklaratën *vetting* “Shtëpi banimi me sip. 180 m², në New York, ShBA”, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016;
 - b) mjaftueshmërisë dhe burimit të ligjshëm të krijimit të kursimeve në depozitat bankare në Chase Bank dhe TD Bank, në New York, ShBA, për periudhën 2003 – 10.07.2014, në vlerën rreth 25.863 USD;
 - c) pamundësisë së subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pagimin e kredisë për shkollimin e bashkëshortes në vlerën prej 8.532 USD, për shkak të pamjaftueshmërisë së konstatuar ndër vite, që në rezultatin financiar të vitit 2015 arrin në vlerën (-) 21.140 USD.
4. Shumica e trupit gjykues të Kolegjit në këtë vendim⁸², lidhur me kontrollin e vendimit të Komisionit, mbi bazën e shkaqeve të ankimit të ngritura nga Komisioneri Publik, në përfundim, ka konkluduar në paragrafët e mëposhtëm:

19.26. Në përmbledhje të sa është argumentuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar shkakun e ankimit të Komisionerit. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në

⁸² Vendimi nr. 8, datë 02.03.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi.

deklaratën e pasurisë vetting, si për sa i përket shumës së kredisë së përfituar për krijimin e kësaj pasurie, ashtu edhe për sa i përket pagesës së pretenduar si kësti i dytë i shlyerjes së kësaj pasurie. Nga aktet në fashikull, rezulton që detyrimin kushtetues e ligjor për deklarim të plotë e të saktë të kredisë dhe pagesave të kryera, subjekti i rivlerësimit e ka përmbushur për herë të parë vetëm në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të drejtuar atij nga Komisioni, me një pyetje shumë specifike për vlerën e saktë të kredisë së përfituar. Po ashtu, vetëm në pyetësorin nr. 3, subjekti i rivlerësimit përmbushi për herë të parë edhe detyrimin për dorëzimin e kontratës së plotë të shitjes së kësaj pasurie, ku saktësoheshin vlerat financiare që shoqërojnë transaksionin e blerjes së kësaj pasurie, sikurse edhe pagesën e një vlere prej 46.638,43 USD, të kryer më datë 21.05.2012.

19.27. Shpjegimet e subjektit, për arsytet për të cilat nuk ka dhënë shpjegime të plota, të sakta dhe shteruese mbështetur në dokumentacion, rezultuan jobindëse dhe u panë nga trupi gjykues i Kolegjit si një përpjekje për të pamundësuar kontrollin e plotë të pasurisë, të cilit ai i nënshtrohej në kuadër të procesit të rivlerësimit, për shkak të detyrës si gjyqtar. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimet që burojnë nga neni D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

*20.10. [...] Për të njëjtën arsye dhe duke mbajtur në konsideratë që kjo kërkesë e subjektit të rivlerësimit është parashtruar në një fazë të avancuar të procesit, dhe pasi atij i ishin pranuar të gjitha shpenzimet sipas deklarimeve, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se pretendimi i subjektit në Kolegj është i pabazuar. Në përfundim, subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të paguar këstin e parë dhe të dytë për krijimin e pasurisë “Shtëpi banimi në {***} New York” dhe nuk arriti të rrëzonte barrën e provës për të provuar të kundërtën e pretendimeve për balancë negative prej (-) 16.000 USD, parashtruar nga Komisioneri Publik.*

21.10. Në përmbledhje, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e depozitave bankare në Chase Bank dhe TD Bank, të deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, sikurse edhe për të kryer shpenzimet e vitit 2015. Edhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës së dhënë nga Komisioni gjatë hetimit administrativ për këto pasuri dhe për sa parashtruar në ankimin e Komisionerit Publik. Për rrjedhojë, edhe për këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimet që burojnë nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, të parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

5. Kam shprehur mendim të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, duke bërë një vlerësim tërësor të çështjes, në analizë të shkaqeve të ankimit të Komisionerit, si dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, me këto argumente:

5.1 Komisioneri Publik në ankim dhe shumica e Kolegjit në vendim nuk kanë mbajtur si duhet në konsideratë rrethanat dhe situatën faktike të subjektit të rivlerësimit që këto pasuri janë krijuar gjatë një periudhe kohore kur subjekti nuk ka qenë pjesë e sistemit gjyqësor në ushtrim të funksionit të gjyqtarit, konkretisht në periudhën 2003 – 2014. Në vlerësimin tim, kjo periudhë e gjatë prej 11 vitesh jetese dhe pune në ShBA, i ka mundësuar subjektit që të krijojë pasuritë e lartpërmendura, të cilat gjatë procesit të rivlerësimit nuk mund të kenë të njëjtën peshë në kontrollin e ligjshmërisë së krijimit të tyre, sikurse kanë pasuritë e krijuara pas vitit 2014, kur subjekti është kthyer në sistemin gjyqësor e, për të cilat, ka pasur detyrimin ligjor të deklarimit

vjetor periodik e kontrollit të pasurisë. Sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 32⁸³ të ligjit nr. 84/2016, subjekti rezulton se i ka përmbushur kërkesat e kësaj pike për deklarimin e pasurisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Prej tij janë paraqitur dokumentet bankare, si dhe vërtetimet e tatim taksave, të cilat provojnë pretendimet e subjektit parashtruar si në gjykimin e çështjes në Komision, ashtu edhe në Kolegj, për të ardhura të ligjshme për krijimin e pasurisë dhe për mundësinë e tij dhe familjarëve të tij për t'i krijuar ato.

5.2 Pasuritë, objekt ankimi nga Komisioneri Publik, janë krijuar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me të ardhurat familjare të tyre, si dhe me kredi bankare. Subjekti i rivlerësimit, si në deklarimin para fillimit të detyrës në vitin 2014, ashtu dhe në deklaraten *vetting*, i ka deklaruar këto pasuri, si dhe detyrimet financiare të krijuara në ShBA. Gjithashtu, shumica duhej të mbante në konsideratë edhe faktin e parashtruar nga subjekti i rivlerësimit që këto pasuri të krijuara në ShBA, në zbatim të legjislacionit shtetëror dhe federal, kanë kaluar në filtra verifikimi e kontrolli nga autoritetet ligjzbatuese në ShBA në lidhje me taksat, tatimin e të ardhurave, testin e pastrimit të parave, si dhe nga institucionet private bankare në lidhje me verifikimet e kryera për dhënien e huasë. Rezulton që ky fakt të mos jetë kundërshtuar nga shumica e trupit gjykues.

5.3 Rezulton e provuar se nga viti 2003 deri në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij, pasi kanë jetuar e punuar për rreth 9 vjet në ShBA, me të ardhurat e krijuara, si dhe nëpërmjet një kredie bankare, kanë arritur të blejnë shtëpinë e banimit me sip. 180 m², në New York, të përbashkët me vëllanë e subjektit (respektivisht 90 m² sipërfaqe takuese për secilin). Pra, pasuria objekt ankimi nuk është krijuar në vitet e para të jetesës në ShBA, por pasi subjekti dhe familja e tij, nën regjimin e një jetese të përbashkët (bashkëshortja, babai, nëna e vëllai me bashkëshorten), kanë krijuar të ardhura nga puna dhe pensioni (prindërit). Ky fakt i pakundërshtuar edhe nga shumica e trupit gjykues më krijon bindjen që pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit, pas një pune shumëvjeçare në ShBA, të kenë burimin nga të ardhura të ligjshme.

5.4 Shprehem dakord me kërkimin e Komisionerit Publik dhe shumicën e trupit gjykues që kontrolli i analizës financiare të fillojë që në vitin 2003, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit në periudhën 2003 – 2004 nuk ka krijuar pasuri⁸⁴, por ka krijuar të ardhura sa për të përballuar shpenzimet financiare dhe për të mos rezultuar me balancë negative.

5.4.1 Por, në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në gjykim subjekti i rivlerësimit, me provat e paraqitura në Kolegj (*licencën e agjentit imobiliar, S. P., të lëshuar në datën 31.12.2004 nga Departamenti i Shtetit të New York-ut dhe kopjen e kartës së identifikimit në biznesin privat, lëshuar nga Washington Inventory Service, printuar më datë 29.12.2004*), mundi që të provojë qenien e tij në marrëdhënie pune dhe realizimin e të ardhurave të ligjshme. Me provat e paraqitura, subjekti mundi të provojë se ka realizuar të ardhura edhe për periudhën 2003 – 2004, duke punuar në ShBA (*më së paku nga data 13.07.2004, kur ka fituar statusin e azilantit politik*), për të përballuar nevojat e jetesës, dhe në kushtet kur gjatë gjykimin u provua se të dhënat e kërkuara nuk mund të gjendeshin për shkak të kalimit të afatit 10-vjeçar të ruajtjes së tyre. Për sa më lart, Kolegji

⁸³ Neni 32, pika 3 parashikon se: “3. Nëse subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur kanë pasuri jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ai paraqet deklaratimet bankare të viteve të fundit, të dhënat e fundit mbi regjistrimin e pasurisë ose dokumente të tjera që tregojnë vlerën e pasurive që ndodhen jashtë shtetit”.

⁸⁴ Sipas deklaratimit të subjektit të rivlerësimit rezulton vetëm blerja e automjetit BMW, në prill të vitit 2005, në vlerën 13.000 USD, që në kushtet e jetesës në ShBA përbën një domosdoshmëri për familjen.

duhet të kishite pasur parasysh përcaktimin e nenit 32, pika 2⁸⁵ e ligjit nr. 84/2016, duke pranuar pamundësinë objektive të provimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit (lidhur me paraqitjen e *tax return* për vitet 2003 – 2004).

5.5 Pavarësisht deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe akteve që ai ka depozituar për të përmbysur barrën e provës gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, vlerësoj se sërish mbetet rezerva e pamundësisë për të njohur në mënyrë të plotë e të qartë jetesën e subjektit të rivlerësimit gjatë viteve të punës në Amerikë në funksion të krijimit të të ardhurave e shpenzimeve të kryera, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në krijimin e pasurive objekt ankimi. I qëndroj mendimit se në rastin konkret dhe për specifikat e këtij rasti, në kushtet kur nuk ka qartësi për të konkluduar për mjaftueshmërinë financiare, lidhur me krijimin e pasurive objekt ankimi, shumica nuk duhej të pranonte shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, duke mbajtur në konsideratë parashikimin ligjor të nenit 32, në pikat 2 e 3 të ligjit nr. 84/2016⁸⁶, parashikim i cili është shkruar nga ligjvënësi për t'u zbatuar, jo vetëm nga subjekti i rivlerësimit si detyrim ligjor, por edhe nga organet e rivlerësimit si diskrecion i rasteve me natyrë tejet specifike. Në këtë rast i shoh të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën këto dy pika të nenit 32 të ligjit në funksion të argumentit, që derisa rezulton e provuar që subjekti i rivlerësimit për pasuritë e krijuara në ShBA, me të ardhura nga puna në këtë vend, ka paraqitur në përputhje me parashikimin ligjor deklaratimet bankare të viteve të fundit e të dhënat e fundit mbi regjistrimin dhe vlerën e këtyre pasurive, atëherë organi i rivlerësimit, duke ushtruar diskrecionin e tij do të duhej të konsideronte pamundësinë objektive për të disponuar dokumente tej afateve ligjore të legjislacionit të shtetit të huaj dhe në interpretim të këtyre dy rregullimeve ligjore dhe analizës së provave të paraqitura nga subjekti, të vlerësonte realisht situatën financiare të subjektit gjatë periudhës që ai ka jetuar e punuar në ShBA.

5.6 Vlerësoj të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2005 – 2014 rezulton i përlllogaritur në mënyrë të dubluar shpenzimi për qiranë. Komisioni e ka përlllogaritur dy herë të njëjtin shpenzim, edhe të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si shpenzim për qira, edhe në përbërje të shpenzimeve të jetesës, referuar *indeksit poverty threshold* (ku qiraja/strehimi është një nga elementët përbërës të këtij indeksi). Kështu, për periudhën shtator 2003 – gusht 2010 shpenzimet e qirasë janë konsideruar 1.500 USD/muaj dhe për periudhën shtator 2010 – korrik 2012 janë konsideruar 1.800 USD/muaj. Përderisa rezultoi se në shpenzimet e jetesës, referuar *indeksit poverty threshold*, përfshihen shpenzime qiraje në përqindje të ndryshme, këto vlera që rezultojnë më të vogla se shpenzimet e qirasë së deklaruar, duhet të jenë të përfshira vetëm një herë në analizën financiare.

5.6.1 Pavarësisht mënyrës së interpretimit në vendim nga shumica, ndikimi në efektin financiar i kësaj përlllogaritjeje të dubluar të shpenzimit të qirasë është i tillë që kthen tërësisht balancën e analizës financiare nga negative (në vlerën – 24.593 USD për vitin 2014 dhe në vlerën – 21.140 USD për vitin 2015), në pozitive, ku mundësia për kursime e subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij për periudhën 2003 – 2015 do të rezultonte në vlerën 50.448 USD. Pra, zbritja e përqindjes së qirasë, e cila ka një peshë të konsiderueshme në analizë, në vlerën prej 88.248 USD, bën që

⁸⁵ Neni 32, pika 2 parashikon se: “2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”.

⁸⁶ Referoju footnote 2 dhe 4.

shkaku i ankimit të Komisionerit Publik për pamjaftueshmëri financiare të burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive në SHBA të mos jetë i bazuar. Kështu, provohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi që të krijojë pasuritë objekt ankimi me të ardhura nga burime të ligjshme dhe të paguajë kreditë e marra për shtëpinë dhe shkollimin e bashkëshortes. Për sa arsyetuar më sipër, vlerësoj se rëndimi i pozitës së subjektit të rivlerësimit, duke i përlllogaritur dy herë në analizën financiare shpenzimin e qirasë, nuk mund të çojë në aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

5.7 Ndaj mendim të kundërt me shumicën, që ka rrëzuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me dublimin e shpenzimit të qirasë, se ai e ngre këtë pretendim për herë të parë⁸⁷ gjatë gjykimit në Kolegj, duke mos e pretenduar në Komision gjatë hetimit administrativ dhe kur i kanë përcjellë rezultatet e hetimit dhe analizën financiare⁸⁸. Vlerësoj se subjekti i rivlerësimit e ka ngritur këtë pretendim për herë të parë në Kolegj si rezultat i mbrojtjes që i është dashur të bëjë ndaj shkakat të ankimit të ngritur nga Komisioneri Publik, për sa kohë gjykimi i çështjes në Kolegj ka filluar mbi bazën e ankimit të vendimit të konfirmimit të subjektit. Në ankim janë paraqitur shkaqet e ankimit dhe pretendimet e Komisionerit, pse vendimi i Komisionit duhet të ndryshohet. Referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, të cilat janë të aplikueshme edhe në gjykimin e çështjes në Kolegj, gjykimi i çështjes zhvillohet mbi bazë të parimit të kontradiktoritetit⁸⁹. Në përmbushje të këtij përcaktimi ligjor, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë ligjore të kundërshtojë me argumente ligjore dhe prova pretendimet e palës në gjykim, në këtë rast të Komisionerit Publik. Ky kundërshtim vlerësohet prej vetë palës se si do të realizohet dhe kush është mënyra e mbrojtjes së saj. Për sa kohë Komisioneri Publik ka parashtruar në ankim situatën e shpenzimeve për jetesë të subjektit dhe në vlerësim të subjektit i ka keqinterpretuar ato, këtij të fundit i lind e drejta e kundërshtimit me provat që ai vlerëson se janë të vlefshme. Në rastin e këtij gjykimi, që sipas ligjit nr. 84/2016 mund të konsiderohet një gjykim apeli, subjekti i është referuar, për mbrojtjen e interesit të tij, provave të ndodhura në dosjen e Komisionit dhe nuk ka paraqitur prova të reja, pavarësisht se si janë interpretuar ato në gjykimin në Komision. Në këto kushte, Kolegji nuk mund të mos pranonte kërkimin e tij për rivlerësimin e situatës mbi bazën e këtij kërkimi, për sa kohë është detyrim i tij ligjor t'u japë vlerë provave të paraqitura e të ndodhura në dosje, sipas rrethanave dhe bindjes së brendshme edhe pa u kërkuar nga pala. Praktika e Kolegjit, në rolin e kontrolluesit të vendimeve të Komisionit, ka ecur në shumë raste edhe në korrigjimin e analizave financiare, bazuar në shkaqet e ankimit, në interpretimin në mënyrë të ndryshme nga Komisioni të situatave financiare që kanë sjellë ndryshim të vlerësimit të Kolegjit nga vlerësimi i Komisionit.

5.8 Nga kontrolli i vendimit të Komisionit, kryer nga Komisioneri dhe në Kolegj, rezultojnë disa pasaktësi e mospërputhje në deklaratimet e deklaratave para fillimit të detyrës 2014 dhe asaj *vetting* të subjektit të rivlerësimit, që i referohen dokumentacionit ligjor të krijuar për blerjen e pasurisë dhe marrjen e kredisë, si kontrata e shitjes së shtëpisë, kontrata e kredisë, vlera e kredisë e modalitetet e pagesës së kështit të dytë të shlyerjes së blerjes së pasurisë *shtëpi banimi me sip. 180*

⁸⁷ Paragrafi 20.9 i këtij vendimi të Kolegjit.

⁸⁸ Në balancën negative të përcjellë nga Komisioni për periudhën 2005 – 2014, në vlerën prej (-) 156.153 USD përfshihej edhe vlera e qirasë për banesën.

⁸⁹ Nenet 19 e 20 të Kodit të Procedurës Civile parashikojnë se: Neni 19: "Palët duhet t'i bëjnë të njohur njëra-tjetrës, në kohën e duhur, mjetet dhe faktet mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre, provat që do të paraqesin dhe dispozitat ligjore që do t'u referohen, në mënyrë që të bëhet e mundur për secilën palë mbrojtja e interesave të tyre në gjykim". Neni 20: "Gjykata duhet të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktoritetit. Ajo mbështet vendimin e saj vetëm në mjetet, shpjegimet, dokumentet e provat e tjera të treguara ose të sjella nga palët, kur këto të fundit kanë qenë në gjendje të debatojnë sipas parimit të kontradiktoritetit".

m², në New York. Pasaktësitë e arsyetuara në vendimin e shumicës lidhen më tepër me analizën e shpjegimeve të subjektit, deri diku kontradiktore dhe të pasakta, por që nuk ndikojnë në çështjen kryesore të procesit, atë të krijimit të të ardhurave dhe vlerësimit të ligjshmërisë së krijimit të pasurive objekt ankimi. Mbetet fakt tërësisht i provuar se pasuria *banesë në SHBA*, në bashkëpronësi të subjektit dhe vëllait të tij, është një pasuri e krijuar prej tij me të ardhura të ligjshme nga puna në SHBA, rezultat i punës së tij dhe familjarëve të tij, si dhe i një kredie bankare, e cila vazhdon të shlyhet në kohë. Në vlerësimin tim, pasaktësitë e paqëllimshme, që nuk shoqërohen me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme financiare, nuk duhet të çonin në pasojën e ndryshimit të vendimit të Komisionit dhe dhënien e masës më të rëndë, atë të shkarkimit të subjektit. Duke qenë dakord me vendimmarrjen e Komisionit e duke i konsideruar të parëndësishme mospërputhjet e pasaktësitë në deklarime çmoj se ato duhet të ishin vlerësuar në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit. Pasaktësitë e konstatuara nga Kolegji dhe mospërputhjet e shpjegimeve të dhëna prej tij, të para në mënyrë të shkëputur nuk mund të sjellin pasojë shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, sipas nenit 61, pika 3 e tij.

6. Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, konkludoj se ankimi i Komisionerit Publik, për shkaqet e mësipërme, nuk duhet të pranohet dhe vendimi nr. 519, datë 25.3.2022, i Komisionit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi, është i drejtë dhe i bazuar në fakte e në ligj dhe, për këtë arsye, duhej të lihej në fuqi.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi